



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.01.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 21 janar – 8 shkurt 2019;
3. Shqyrtimi i aktit normativ nr. 2, datë 19.12.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për buxhetin e vitit 2019””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Vullnet Sinaj, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Edmond Haxhinasto, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj dhe Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Agron Shehaj, Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Anila Denaj - Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Suzana Stefa – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Demko – përfaqësuese nga kabineti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Erjon Braja – përfaqësues nga kabineti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi - drejtor

Kejdi Mehmetaj – deputete

Floida Kërpaçi – deputete

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përsëndetje!

Para se të fillojmë me aktin normativ, në bazë të procedurës, kalojmë te miratimi i programit dhe kalendarit trejavor të punës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat për periudhën deri më 8 shkurt.

A jeni dakord me kalendarin?

Miratohet.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës: shqyrtimi i aktit normativ nr.2, datë 19.12.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018””.

Do të diskutojmë aktin në parim. Nga qeveria kemi të pranishme ministren e Financave dhe të Ekonomisë dhe stafin që e shoqëron. Relator është zoti Ervin Bushati.

Fjala për ministren.

Jorida Tabaku - Unë do t’ju kërkoja që këtë seancë të mos e drejtoni ju, sepse keni konflikt interesi. Zoti Angjeli mund t’ju ndihmojë në drejtimin e seancës dhe ne do të bëjmë diskutimet me qeverinë dhe ministren e re të Financave. Nuk do të ketë ndonjë gjë të madhe për diskutim, por besoj se, meqë ka ardhur me firmën tuaj, do të ishte normale që ju të mos ishit i përfshirë në drejtimin e seancës.

Arben Ahmetaj- Besoj se nuk është konflikt interesi të diskutosh për ligjet dhe aktet normative, kudo që të jem, qoftë aty, qoftë këtu, sepse, në radhë të parë, është interesi publik dhe nuk ka konflikt me interesin publik në këtë sallë.

Së dyti, nëse shkruhet diku kjo, me kënaqësi do të tërhiqesha nga drejtimi i komisionit. Nëse nuk shkruhet, faleminderit, dhe vazhdojmë diskutimin.

Besoj se çdo diskutim moral kalon nëpërmjet procedurës dhe ligjit, kështu që, meqë nuk është shkruar, fjalën e ka ministrja. Këtë e ka përgatitur Këshilli i Ministrave.

Anila Denaj – Të nderuar deputetë, para se të prezantoj objektivat kryesore të aktit normativ të buxhetit të vitit 2018, si edhe elementet specifike të tij, më lejoni të paraqes shkurtimisht zhvillimet kryesore makroekonomike gjatë vitit 2018.

Gjatë këtij viti ekonomia ka filluar të ndjekë trendin përshpejtues të ritmit të rritjes. Në 9 muajt e parë të vitit 2018 ekonomia u rrit me terma reale në rreth 4,4 % kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Gjatë kësaj periudhe, por sidomos për tremujorin e tretë, kërkesa e brendshme

është nxitur kryesisht nga kontributi i konsumit, por në një masë të konsiderueshme edhe nga investimet totale në ekonomi. Konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me 2,83%, në terma realë vjetorë përgjatë 9 muajve të parë të vitit 2018, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 3,41%. Investimet totale u rritën me rreth 3,89%, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2018 norma e rritjes për investimet u zgjerua në 5,4%. Rritja e produktit të brendshëm bruto ishte përgjithësisht e diversifikuar në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë. Sektori me kontributin më të lartë është ai i industrisë, i pasuar nga sektori i shërbimeve, ku spikat sektori i turizmit. Gjithashtu, edhe sektori i bujqësisë dhe ndërtimit patën një rritje dhe kontribut të qenësishëm pozitiv. Presim që rritja ekonomike për të gjithë vitin do të jetë të paktën sa projeksioni fillestar i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për një rritje vjetore prej 4,2%. Vlen për t'u përmendur se edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, pas publikimit të rritjes ekonomike për tremujorin e tretë, ka rishikuar për herë të dytë në rritje projeksionin e saj për vitin 2018, duke e çuar në nivelin 4,2%. Performanca e mirë ekonomike ka sjellë zhvillime pozitive edhe në tregun e punës. Sipas statistikave të anketës së forcave të punës nga INSTAT-i, norma e papunësisë për moshën 15-64 vjeç ka vijuar trendin e saj rënës që prej tremujorit të parë të vitit 2014, ku është shënuar 18%, në zbritjen deri në nivelin 12,7% në tremujorin e tretë të vitit 2018.

Punësimi deri në tremujorin e tretë të vitit 2018 u rrit me 21,5000 të punësuar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Bazuar në statistikën e Bankës së Shqipërisë, bilanci i pagesave për periudhën janar-shtator të vitit 2018 shënoi përmirësim kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, duke arritur vlerën plus 97,6 milionë euro. Komponenti më i rëndësishëm pozitiv ishte fluksi hyrës i investimeve të huaja direkte, këto të fundit rezultuan me një rritje me rreth 11,6%, kundrejt 9 muajve të parë të vitit 2017, një sinjal mjaft pozitiv ky për perceptimin e investitorëve të huaj për ekonominë tonë. Ndërkohë inflacioni mesatar për vitin 2018 ka rezultuar në nivelin 1,8%, po aq sa edhe një vit më parë.

Sa u takon zhvillimeve kryesore në financat publike, sipas treguesve paraprakë faktikë të buxhetit të vitit 2018, rezulton se të ardhura totale në vitin 2018 patën një rritje prej 4,4 % krahasuar me vitin 2017, ndërsa të ardhurat tatimore, me gjithë efektet domethënëse negative që pati vlerësimi i kursit të këmbimit dhe rimbursimi më i lartë i TVSH-së në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 prej 5,2%, shpenzimet, falë edhe dy rishikimeve të buxheteve që u realizuan gjatë vitit

2018, pra dy akte normative përfshirë edhe këtë që po diskutojmë sot, patën, gjithashtu, një ekzekutim të mirë.

Shpenzimet totale në vitin 2018 ishin 3,1% më lart se një vit më parë, ndërsa shpenzimet kapitale 14,1% më lart se një vit më parë. Sigurisht, rezultuan edhe kursime në shpenzimet korente. Ndërkohë, sa i takon ekzekutimit të shpenzimeve kapitale me gjithë rialokimet e bëra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në dy rishikimet e buxhetit, sërish mbetet mjaft për të përmirësuar në ekzekutimin e tyre veçanërisht prej ministrive kryesore shpenzuese.

Si rezultat i këtyre dhe çka është më e rëndësishme për financat publike, në vitin buxhetor 2018 rezultoi se deficit i përgjithshëm fiskal ishte 1,6% e produktit të brendshëm bruto, i cili është deficit më i ulët i regjistruar vitet e fundit. Balanca primare rezultoi sërish pozitive, pra me një suficit primar prej 0,6% ndaj produktit të brendshëm bruto, borxhi publik neto, i zhveshur nga mjetet likuide të qeverisë, rezultoi në 63,9% të produktit të brendshëm bruto, ndërsa borxhi publik bruto në fund të vitit 2018 rezultoi në nivelin 67, 2% të produktit të brendshëm bruto, me një reduktim prej 3 pikësh përqindjeje nga viti 2017.

Për ta mbyllur, në zhvillimet gjatë vitit 2018 sigurisht duhet përmendur emetimi i eurobondit jo thjesht për sigurimin e një financimi mjaft optimal të buxheteve, por mbi të gjitha si një reflektim më i mirë dhe më objektiv për përmirësimet që kanë ndodhur në financat publike dhe ekonominë shqiptare gjatë viteve të fundit.

Tani më lejoni të vijoj me objektivat kryesorë që synon ky akt normativ:

Objektivi i parë është të sigurojë hapësirën financiare shtesë për njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së tavanit të shpenzimeve me 3,4 miliardë lekë, në përputhje me ecurinë pozitive në mbledhjen e të ardhurave vendore, të cilat, në fakt, për të gjithë vitin 2018 rezultuan me tejkalim prej 3 miliardë lekë kundrejt buxhetit fillestar të vitit 2018. Performanca më e mirë ka qenë nga zëri i të ardhurave të taksës lokale.

Te pushteti vendor zhvillim tjetër gjatë vitit 2018, i reflektuar edhe në ndryshimet e këtij akti normativ ka të bëjë me faktin se njësitë e qeverisjes vendore gjatë vitit 2018 kanë shlyer detyrimet e prapambetura në shumën 2,1 miliardë lekë, gjithashtu, disa nga qeveritë e vetëqeverisjes vendore kanë zbatuar projekte me financim të huaj, ku plani i tyre në fillim të vitit 2018 nuk i parashikonte. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë trashëguar fonde nga vitet e mëparshme duke krijuar nga njëri vit në tjetrin një stok që ka rritur presionin për të paguar shpenzimet. Në këto kushte ishte e domosdoshme edhe krijimi i hapësirës fiskale për mbulimin

me plan buxhetor të shpenzimeve me financim të huaj për pushtetin vendor në vlerën 1,3 miliardë lekë.

Objektiva të tjerë që mundëson ky akt normativ janë: të rrisë performancën e shpenzimeve kapitale përmes rialokimit të fondeve me projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm dhe të huaj; të realizojë shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e infrastrukturës në përputhje me angazhimin e marrë edhe ndaj FMN-së përmes akordimit të fondeve të nevojshme për shlyerjen e rreth 2,2 miliardë lekë fatura të projekteve në vijim; të garantojë mbulimin me fonde buxhetore për disa çështje parësore dhe konkretisht: financimin e konvikteve të studentëve në Bashkinë e Tiranës në masën 300 milionë lekë; financimi i stadiumit të Kukësit në masën 200 milionë lekë; financimi i investimit për kampusin universitar Durrës në masën 150 milionë lekë; financimi i projektit të rikonstruksionit të Teatrit të Operës dhe Baletit në masën 210 milionë lekë; mbështetje AKSHI-t, financimi i investimit të nevojshëm shtesë për Spitalin e Traumës në masën 470 milionë; financimi i projektit të Bankës Botërore “Financimi i sistemit shëndetësisë”, në masën 500 milionë lekë; shlyerje e detyrimeve të prapambetura për disa institucione buxhetore; rritje e mbështetjes buxhetore me burime të huaja për energjinë në masën 1,2 miliardë lekë përmes alokimit të këtij fondi në programin “Mbështetje për energjinë”.

Në vijim, akti normativ ka objektiv të mbulojë me financim detyrime për disa objekte të rëndësishme investimesh publike, siç janë: ndërtimi i unazës së jashtme të Tiranës, pjesa e mbetur e punimeve në segmentit Lin-Pogradec; loti i 3-të i aksit Librazhd-Qafë Studën, ndërtimi i aksit rrugor Skrapar-Përmet; shlyerja e vendimeve gjyqësore të prapambetura; shlyerja e detyrimeve për TVSH-në; kostoja lokale në programet transport rrugor dhe infrastrukturë e ujitjes dhe e kullimit.

Në fund të fjalës sime të parë në këtë komision, të nderuar parlamentarë, dua të theksoj angazhimin tim maksimal për të shtyrë përpara reformat e kësaj maxhorance si udhërrëfyesi më i mirë dhe i vetëm në rrugën e zhvillimit të vendit tonë. Do të jem në krye të punës për të lehtësuar dhe shpejtuar ofrimin e shërbimeve cilësore dhe transparente në drejtim të secilit tatimpagues. Do të sigurohem, gjithashtu, në çdo hap dhe në çdo fazë për intensifikimin e punës kundër informalitetit dhe padrejtësisë në treg, pasi besoj se është një nga shtyllat kryesore të konsolidimit ekonomik dhe provimit të konkurrencës në treg të një shoqërie që po tenton të lërë një periudhë tranzicioni dhe të ecë në terren të frytshëm.

Do të intensifikoj komunikimin me sipërmarrjen vendase dhe të huaj për të adresuar kërkesat e tyre në legjislacion dhe në paketat e ardhshme fiskale me qëllim ofrimin e një ambienti të rregullt dhe një klimë optimale biznesi. Sigurisht, të gjitha këto dhe politika të tjera publike nuk do të cenohen në asnjë moment, përkundrazi do të stabilizojnë më tej treguesit kryesorë makro-ekonomikë të Shqipërisë, rritjen ekonomike të qëndrueshme, mbajtjen e deficitit buxhetor dhe borxhit publik në nivelin më të ulët që regjistrohet sot.

Kjo është fjala ime e parë, angazhimi do të vazhdojë më tej me punën time.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju ftoj, të nderuar deputetë, ta votoni këtë akt normativ!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Në emër të komisionit, jam i bindur edhe majtas, edhe djathtas, ju urojmë suksese në detyrën tuaj!

Fjalën e ka relatori.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Gjatë vitit 2018 ekonomia shqiptare vijoi me tendencë pozitive. Rritja reale e GDP-së nga 3,8% në vitin 2017, arriti në 4,2% në vitin 2018. Kjo rritje u pasqyrua në shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese, rritjen e punësimit, reduktimin e normës së papunësisë dhe forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Sektorët kryesorë që mbështetën rritjen ekonomike ishin industria dhe shërbimet. Nga pikëpamja e kërkesës agregate rritja ekonomike vijoi të mbështetej nga zgjerimi i konsumit, investimet private dhe eksportet. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik vijoi të mbështetej nga politika monetare stimuluese dhe të Bankës së Shqipërisë. Edhe gjatë vitit 2018 vijoi dhe u thellua më tej konsolidimi fiskal, i cili u reflektua në reduktimin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik në tërësi. Norma e papunësisë u ul, nga 14,1% në vitin 2017, në 12,8% në vitin 2018 dhe parashikohet të reduktohet edhe më tej për çdo vit në të ardhmen afatmesme.

Nevoja për ndryshime në buxhet lindi në muajin dhjetor 2018, pas analizës së rezultateve të 11-mujorit dhe qartësimit të plotë të situatës makroekonomike, fiskale e buxhetore të bërë nga Këshilli i Ministrave, ku u konstatua se në disa zëra ekzistonin akoma fonde të lira, të cilat mund të përdreshin në disa destinacione të tjera të nevojshme dhe prioritare. Për të bërë të mundur përdorimin e këtyre fondeve lindi nevoja e disa rialokimeve në buxhetin vjetor. Më poshtë po rendis arsyet.

Së pari, akti normativ vazhdon të ruajë të pandryshuar treguesit makroekonomikë dhe fiskalë të parashikuar në fillim të vitit 2018, duke vijuar tendencën e konsolidimit fiskal, me qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe menaxhimin me efektivitet të financave publike, që është kushti i parë.

Deficiti buxhetor mbetet në 2% të PPB-së, ndërsa suficiti primar mbetet në terma pozitivë, 8,6 miliardë lekë ose 0,5% e GDP-së.

Së dyti, akti normativ siguron mbështetje financiare për reformat e nisura në ekonomi, e cila së bashku me konsolidimin fiskal krijon kushte për vazhdimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Së treti, sigurohet mbështetje financiare shtesë për pushtetin vendor, duke rritur shpenzimet e tij me 3,4 miliardë lekë si rezultat i rritjes së të ardhurave vendore në masë të konsiderueshme mbi nivelet e planifikuara. Nga këto, me rreth 1,3 miliardë lekë rriten shpenzimet në financim të huaj për pushtetin vendor. Kjo politikë i shërben thellimit të mëtejshëm të reformave dhe decentralizimit të ekonomisë.

Së katërti, rriten të ardhurat e pushtetit vendor. Kjo gjë u prek edhe nga ministrja gjatë fjalës së saj, prandaj nuk po e vazhdoj më tej.

Së pesti, shuhet detyrimet e prapambetura në sektorin e infrastrukturës në masën 2,2 miliardë lekë në përputhje me angazhimet ndaj FMN-së. Kjo synon të arrihet nëpërmjet rialokimeve eficiente të detyrimeve financiare, kontraktore të institucioneve buxhetore.

Së gjashti, rialokohen fondet për investime publike drejt projekteve të investimeve me ecuri të mirë. Prioritet i jepet rritjes së mbështetjes buxhetore në burime të huaja për energjinë elektrike, të cilat rriten me 1,2 miliardë lekë.

Së shtati, korrektohet niveli i të ardhurave të përgjithshme buxhetore për të reflektuar reduktimin me 2,1 miliardë lekë të të ardhurave tatimore-doganore, si rrjedhojë e efekteve negative të kursit të këmbimit.

Së teti, bëhen disa ndryshime të tjera të nevojshme për funksionimet e institucioneve buxhetore.

Në përgjithësi, përmes këtij akti normativ synohet mbështetja financiare për rikonstruktimin e disa objekteve prioritare që u përmendën pak më parë. Ndryshimet buxhetore luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin e sistemit të arsimit, të shëndetësisë, të infrastrukturës, të qeverisjes vendore e të tjera.

Rialokimi i fondeve buxhetore në destinacionet e rishikuara duhet miratuar brenda një periudhe sa më të shkurtër për të siguruar bërjen efektive të tyre deri në fund të vitit. Për këtë arsye ndryshimet buxhetore u miratuan me këtë akt normativ. Procedura e miratimit të ndryshimeve buxhetore me akt normativ është një procedurë e ndjekur prej vitesh dhe plotëson kërkesat e nenit 101 të Kushtetutës, që janë: nevoja, urgjenca dhe përkohshmëria deri në miratimin e ligjit nga Kuvendi. Ky akt normativ duhet të miratohet nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Mbështetur në argumentet e paraqitura më lart dhe nga ato që paraqiti edhe ministrja e Financave, i propozoj komisionit miratimin e aktit normativ të sjellë nga Këshilli i Ministrave.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Bushati!

A ka pyetje?

Jorida Tabaku – Do të doja shumë t’i uroja ministres së re të Financave suksese në punën e saj, por, fatkeqësisht, në situatën në të cilën ndodhemi zonja ministre nuk mund të bëjë asgjë. Në si opozitë presim që ajo të marrë masa, do ta shikojmë punën e saj, duke filluar me anulimin e koncesioneve, ose rishikimin e disa prej politikave fiskale. Jam e sigurt se nuk do të bëjë asnjë nga këto. Po të ishte viti 2013, do t’ju kisha uruar ndryshe, madje do të kisha shpresuar shumë që do të bëhej një ndryshim në Ministrinë e Financave, por, fatkeqësisht, nuk do t’ia dalësh.

Në lidhje me shqetësimet që ne kemi pasur për vitin 2018, të cilat lidhen në mënyrë specifike edhe me aktin normativ...

Arben Ahmetaj – Më falni, zonja Jorida, a keni pyetje?

Jorida Tabaku – Do të bëj disa komente dhe do t’i shoqëroj me pyetje. Pra, meqë është seanca e parë, ministrja bëri një prezantim për ekonominë, përveç aktit normativ, zoti Bushati, bëri të njëjtën gjë dhe besoj se edhe opozitës i takon të bëjë të njëjtën gjë.

Arben Ahmetaj – Patjetër, por në momentin që vijmë te diskutimet...

Jorida Tabaku – Komentet e mia do t’i shoqëroj me pyetje...

Arben Ahmetaj – A ta ezaurojmë pjesën e pyetjeve dhe më pas...

Jorida Tabaku – Kam vetëm një pyetje.

Zonja Ministre, a do t’i anuloni koncesionet e projektit 1 miliard euro që kanë ardhur të gjitha me ofertë të pakërkuar?

Anila Denaj – Më duket se ky nuk është objekti i diskutimit të sotëm, sepse jemi mbledhur për aktin normativ dhe besoj se duhet të diskutojmë për të.

Jorida Tabaku – Zonja Ministre, ju vetë diskutuat për borxhin dhe ne bashkë me diskutimin e borxhit mund t'i futemi edhe këtij diskutimi se lidhet me PPP-të. Ju vetë folët për zbatimin e projekteve të investimit, prandaj unë mund ta lidh pyetjen time edhe me këtë.

Më lejoni të bëj komentet e mia ose ta organizojmë në formë bashkëbisedimi dhe më pas të ngremë pyetje ose ministrja të mos i përgjigjet asnjë pyetjeje dhe të vazhdojmë vetëm me komentet.

Arben Ahmetaj – Për ta zhvilluar normalisht diskutimin vazhdojmë me pyetjet, si nga ana juaj, ashtu edhe nga ana e Partisë Socialiste dhe më pas kur të kalojmë te diskutimet, secili prej jush mund të diskutojë si të dojë dhe për çfarë të dojë në lidhje me aktin normativ apo edhe më gjerë. Si fillim do të doja të ecnim sipas procedurës, të fokusohemi te pyetjet, përgjigjet e qeverisë dhe më pas, në vazhdimësi, të vijmë te komentet dhe te votimi.

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Së pari, i uroj mirëseardhjen zonjës ministre në Komisionin e Ekonomisë.

Me thënë të drejtën, pavarësisht se thuhet 4.4%, jua ka lënë në ditën më të vështirë kryetari gjendjen ekonomike dhe financiare të vendit.

Pyetja që bëri zonja Tabaku mendoj se ka lidhje edhe me vitin 2018, pasi ne po mbyllim treguesit e këtij viti. Ky akt normativ mbyll këta tregues. Normalisht që do të diskutojmë se çfarë kemi planifikuar dhe çfarë kemi realizuar gjatë vitit 2018 dhe implikimet që kanë për vitin 2019, sepse janë të lidhura një sërë çështjesh. Veçanërisht paketa e PPP-ve ka filluar më herët se viti 2018, por është zhvilluar gjatë këtij viti dhe një pjesë e tyre do të zhvillohet gjatë vitit 2019, madje ka një lëvizje...

Arben Ahmetaj – Zoti Spaho, përgjigjuni pyetjes!

Edmond Spaho – Për pyetjen që bëri zonja Tabaku po flas.

Kemi dëgjuar një iniciativë nga qeveria që në korrik do të sjellë një projektligj ku do të ndalohen propozimet e pakërkua. Kjo është shumë interesante dhe, nëse e keni seriozisht, duhet që edhe këto që i kemi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, të mund t'i ndalojmë. Ndaj insisto i edhe zonja Tabaku. Edhe unë, gjithashtu, do të isha i interesuar të dija se si do të veprojë qeveria për këtë çështje, pasi lidhet edhe me vitin 2018, edhe me vitin 2019. Është ekzaktësisht në rendin e ditës që po diskutojmë sot.

(Mungesë incizimi)

Arben Ahmetaj – E drejtoj unë komisionin dhe të drejtën për t’jua dhënë fjalën e kam unë, prandaj, ju lutem, zonja Tabaku...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di unë! Ndoshta ministrja refuzon të përgjigjet, ose kërkon fjalën. Ju nuk e drejtoni dot zonjën ministre!

Fjala për zonjën ministre.

Anila Denaj – Ju e thatë edhe më parë që ka një iniciativë për ligjin, i cili po diskutohet. Ky ligj sigurisht që do të shikojë të gjitha aspektet brenda hapësirave ligjore që lejon, për ato që vijnë dhe ato që janë. Besoj se është platformë më e gjerë diskutimi sesa e kësaj tryeze. Kjo do të ishte qasja ime sot.

Arben Ahmetaj – Ka një sqarim për pjesën...

Edmond Spaho – Nuk u kënaqa me përgjigjen, dua të jap edhe unë reagimin tim! Ç’është ky zevzekllëk, për çdo rast duhet të ndërhyjni?! Nëse doni të debaton politikisht dhe profesionalisht, na lini të debatojmë.

Arben Ahmetaj – Patjetër!

Zoti Spaho, do ta merrni fjalën, por...

Edmond Spaho – Unë nuk po gjuaj me gurë, fjalë po them!

Arben Ahmetaj – Me radhë, ju lutem!

Ka një iniciativë të ndërmarrë nga qeveria, një ligj të dorëzuar në parlament, në dhjetor të këtij viti, i cili rishikon gjithë kuadrin e koncesioneve, por unë dua të shtoj këtu, në emër të maxhorancës, që jo, ne nuk do të heqim dorë nga zhvillimi i investimeve publike edhe nëpërmjet instrumenteve të koncesioneve dhe të PPP-ve. Së pari.

Së dyti, e kam thënë kur kam qenë ministrër i Financave dhe Ekonomisë, po jua them edhe tani, diskutimi që ju bëni është tallje me njerëzit. “Ju i thoni popullit të Dibrës që nuk meritojnë rrugë! Ju i thoni popullit të Shkodrës – “Jo, nuk do ta bëjmë Milot –Ballren”! Ju i thoni popullit të Vlorës që nuk do të bëjmë atë, i thoni popullit shqiptar që nuk do të ketë aeroport, këto thoni ju! Gjithë historia e financave publike është e shoqëruar me instrumentin financiar të partneritetit publik privat, jo vetëm këtu, por në të gjithë botën. Kemi një sërë shembujsh. Megjithatë, ajo që thotë ministrja është e drejtë, patjetër që diskutimi brenda fiskales mund të përfshijë edhe PPP-të. Jemi të hapur ta diskutojmë kur të vijmë te komentet dhe diskutimet, por sigurisht që përpjekja juaj për të demonizuar PPP-në shkon në kundërshtim me interesin publik, me zhvillimin ekonomik

të vendit dhe me interesin e atyre zonave. Ja ku e kemi deputeten e Dibrës, të ngrihet e të na thotë nëse ka ndonjë problem populli i Dibrës me Rugën e Arbrit që po bëhet, iniciativë e drejtpërdrejtë e maxhorancës dhe qeverisë, e bërë me PPP. Jam i bindur që jo, përkundrazi, e kanë mirëpritur. Ju duhet ta thoni vet në fjalën tuaj.

Gjithsesi, unë sugjeroj të vazhdojmë me pyetjet dhe, kur të fillojë diskutimi, të rrimë me orë të tëra të diskutojmë.

Ka pyetje tjetër për ministren?

Edmond Spaho – Dëshiroj të shprehem për pyetjen që bëra dhe për përgjigjen që mora.

Të mos përpiqemi të veprojmë si struci. A po i anuloni PPP-të e pakërkuara në korrik? Do t'i anuloni, sepse kanë dhënë efekt negativ, se ndryshe do të vazhdonit siç keni bërë këta 5 vjet që jeni në qeverisje. Fakti që po i anuloni do të thotë se jua kanë vënë litarin në grykë, jo ju, se po të ishte për dëshirën tuaj, do të vazhdonit kështu, por ka një qëndrim të ashpër të FMN-së në lidhje me PPP-të e pakërkuara, madje ka një paralajmërim për krizë fiskale të Shqipërisë. Kështu që jini seriozë! Nëse i kanë shkaktuar dëme të tilla vendit, atëherë duhet të fillojmë që në janar me urgjencë, nuk ka pse të presim muajin korrik.

Deputetët holandezë erdhën e ta thanë këtui, - “E dini ju që praktika që keni ndjekur për aeroportin e Vlorës është në kundërshtim me kriteret e BE-së për organizimin e tenderimeve të parave publike?!”. Është normale të harxhojmë 20 milionë euro për 1 kilometër tenderim? Mirë ajo rruga që na qenka e domosdoshme, po kjo rruga tjetër është normale, propozim i pakërkuar? Për këto e kemi fjalën, ndaj anulojini nëse doni që ta shpëtoni vendin nga një kërcënim financiar. Ndaj po them se jua ka dhënë në kohën më të keqe këtë detyrë!

Arben Ahmetaj – Zoti Spaho, pyetje nuk kishit dhe tani bëtë koment. Besoj se edhe kur diskutoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju jeni deputet i vjetër dhe e dini procedurën!

Zoti Spaho, unë patjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo maxhorancë nuk ka nevojë për përgjigje individuale! Ato që thoni, që Komisioni Europian ka thënë këtë, ka thënë atë, ku i keni të shkruara, apo do të merremi me përralla?

Edmond Spaho – Janë 8 deputetë holandezë, të cilët thanë se keni shkelur rregullat e prokurimit.

Arben Ahmetaj – Nuk e kanë thënë! Çdo gjë që kalon me ligj është e ligjshme dhe e dyta...
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kalon me ligj në parlament...

Edmond Spaho – Kështu e bën ti, me ligj, sepse të gjithë janë ushtarë dhe ngrenë dorën, pastaj faturën e mbulojnë taksat e shqiptarëve!

Arben Ahmetaj – Këto janë përrallat e tua!

Ku e ke të shkruar? Ku e ke qëndrimin e komisionit të shkruar?

Vazhdojmë me pyetjet, ju lutem!

Blerina Gjylameti - Për procedurë e doja fjalën, nuk kam pyetje, zoti Ahmetaj!

Në radhë të parë, u uroj mirëseardhjen kolegëve të opozitës!

Në radhë të dytë, fakti që sot jeni këtu është një moment shumë i rëndësishëm për ne, por mendoj se do të ishte më tepër e rëndësishme të ishit atëherë kur kishim seancën dëgjimore kur bëhej fjalë për partneritetin publik privat. Mbi të gjitha do të doja, kryetar, këtë e kam për ju, të rikthejmë në normalitet zhvillimin e kësaj mbledhjeje, sepse këtu po flasim për aktin normativ.

Për sa i përket aktit normativ, këtu duhet të diskutojmë *postfactum*, pra ne po bëjmë një ndryshim për të arritur që zërat e ndryshimeve apo dhe të ardhurave t'i çojmë drejt atyre projekteve, të cilat janë më frytdhënëse.

Nëse do të duhet të kemi një seancë tjetër për PPP-të, ta organizojmë së bashku me kolegët e opozitës dhe të vijmë këtu e të flasim për të vërtetat në mënyrë më teknike, për sa kohë që është Komisioni i Ekonomisë. Pjesën politike ta lëmë kur kemi seancë, apo në foltoret e partive përkatëse.

Faleminderit!

Jorida Tabaku - Në qoftë e doni opozitën në këtë komision, sigurisht që ajo do të flasë sipas argumenteve të saj. Kryetar, në këtë komision, me ish-kryetarin e mëparshëm kemi pasur një procedurë ku, të paktën fjalën nuk ia hiqnim dhe as ia ndërprisnim njëri-tjetrit. Nuk na pëlqejnë mendimet e njëri-tjetrit, nuk biem dakord me ato që themi, por ky është rasti i parë që ne po diskutojmë me ministren e re në lidhje me koncesionet. O ka lidhje kjo me aktin normativ, o nuk ka asgjë tjetër. O ka lidhje kjo me ecurinë e ekonomisë, o nuk ka asgjë tjetër.

Në qoftë se nuk doni, atëherë ne largohemi nga Komisioni i Ekonomisë dhe nuk bëjmë asnjë debat dhe ju vazhdoni vetëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lër ta përfundoj! Ervin, nuk të ndërpreva.

Ne largohemi dhe ju vazhdoni vetë, por për sa kohë opozita është këtu, do të vazhdoj të flas dhe të pyes.

Kam një pyetje tjetër për ministren e Financave.

Zonja Ministre, në prill të vitit 2018 hyri në fuqi njëkohësisht edhe vendosja e TVSH-së për bizneset deri në 2 milionë. Nga të ardhurat fiskale të 11-mujorit që kemi... Fatkeqësisht, zoti kryetar, ne nuk i kemi të ardhurat e 12-mujorit. Kjo është edhe një vërejtje për punën tuaj dhe të stafit të ministrisë. Deri tani nuk ka pasur transparencë për të ardhurat dhe për raportimet fiskale. Ne i kemi marrë me vonesë. Ato kërkojnë kohën e tyre, por edhe 11-mujorin e kam marrë vetëm një javë më parë, sigurisht, jo nga stafi i ministrisë, as nga stafi i komisionit. Shpresoj që kjo marrëdhënie të rregullohet dhe të kemi të njëjtin informacion që kanë edhe deputetët e pozitës.

Nga të ardhurat e 11-mujorit TVSH-ja më rezulton me 63 milionë mosrealizim. Njëkohësisht, e keni rregulluar edhe në aktin normativ. Ulen parashikimet për TVSH-në, ulet parashikimi për tatim-fitimin, për akcizën, TAP-in... Pra, ka një sërë të ardhurash, për të cilat ju i keni reduktuar parashikimet. Sipas aktit normativ, deri në momentin kur është raportuar, kjo është pothuajse 60 milionë dollarë (po bëj një ekuivalentim), ndërkohë që sipas fiskales së 11-mujorit është 126 milionë dollarë, 3% më pak se planifikimi fillestar i vitit 2018. Nuk i referohem këtu aktit normativ të korrikut, por planifikimit fillestar.

Sa ka ndikuar përfshirja e biznesit të vogël në skemën e TVSH-së në reduktimin e të ardhurave nga TVSH-ja?

A mund të na siguron një informacion sipas grupeve të bizneseve se si ka qenë e ardhura e TVSH-së?

Anila Denaj – Kam një koment për publikimet.

Shifrat janë publike. Dje dhe sot janë trajtuar edhe në media.

Për çështjen e impaktit fiskal, do t'ia kaloj fjalën zotit Luçi.

Erjon Luçi – Për sa i përket fundit të vitit, diferenca e TVSH-së ka qenë relativisht minimale, duke pasur parasysh efektet e kurseve të këmbimit, që kanë qenë të mëdha. Domethënë, në fund të vitit, nga akti normativ i sapodorëzuar, TVSH-ja është me një diferencë rreth 3 miliardë, që gjithsesi është shumë brenda kursimeve të tjera nga ana e shpenzimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me aktin që po diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me aktin për të cilin po flasim.

Megjithatë, edhe në aspektin e parametrave kryesorë, që u përmendën fillimisht, ato të fundit të vitit janë mirë se ky akt. Me gjithë goditjen e kursit të këmbimit, efektet janë përballuar më së miri.

Për sa u përket të ardhurave mes grupeve, kanë qenë brenda parashikimeve të fillimit të vitit. Kështu që nuk ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë ndryshimi i *threshold*-it, që sapo e diskutuam. Efekti kryesor ka qenë i kursit të këmbimit, që e konfirmoj përsëri, është më se i kompensuar nga kursimet në zëra të ndryshëm, kryesisht interesa apo edhe shpenzime të tjera korente.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka pyetje tjetër?

Po, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, kryetar!

Drejtimit të mbarë të komisionit!

Edhe juve, zonja Ministre, ju uroj suksese në interesin publik!

Duke qenë se këtu u përcaktua që nuk do të ketë shumë komente ose që komentet do të vijnë më pas, si dhe na u përcaktua kuadri ku mund të bëjmë pyetje, kam 2 pyetje për ju.

Me këtë akt normativ, ju, si ministre e re, doni të ndryshoni diçka në mënyrën se si janë drejtuar financat publike? Keni një qëllim, “apo të rregullojmë disa emergjenca”?

Çfarë mendimi keni? A duhet bërë diçka për ndryshimin e mënyrës se si janë drejtuar financat publike, politikat fiskale, monetare, se si janë financuar prioritet ekonomike të vendit, se si është financuar punësimi? Keni edhe portofolin e punësimit, apo jo? Mendoj që ne duhet ta heqim pak shikimin nga ky akt normativ dhe të shohim pak më tej ato që duam të rregullojmë, problemet e mëdha...

Këtu te relacioni juaj shoh se keni lënë disa çështje sensitive. Keni thënë: “Garantohet mbulimi me fonde buxhetore për disa çështje sensitive”. Unë mendoj se çështje më të mëdha sensitive se punësimi, se besimi i rinisë për të qëndruar në vend me një punë të qëndrueshme, se të bërit diçka kundër mpakjes së popullsisë, se rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë në përgjithësi, nuk ka.

Çështjet tuaja sensitive, në fakt, nuk kanë lidhje me gjërat madhore me të cilat duhet të përballlet Shqipëria.

Po rikthehem të pyetja e parë. Ju, nëpërmjet këtij akti, shikoni probleme sensitive në ekonomi, në financa publike, në përgjithësi?

Pyetja e dytë, në këtë linjë mendimi, është për një çështje shumë të madhe, që u bë kombëtare, për kërkesat e studentëve. Ju keni rialokuar para vetëm në financimin e dy kampuseve, në vlerën 450 milionë lekë, me këtë akt normativ. A mendoni që ky veprim, pra alokimi, investimi në këto kampuse, është ekuivalent në ndjeshmërinë ose në rëndësinë e tij me shumë masa të tjera që ju keni adresuar në këtë akt normativ si, për shembull: mbështetje buxhetore për burime të huaja të energjisë, shlyerje detyrimesh të prapambetura, Spitali i Traumës, Tetari i Operas, duke qenë se ka një angazhim të jashtëzakonshëm politik, të paktën si retorikë politike, nga ana e qeverisë se do të adresoni me urgjencë çështjet e studentëve?

I vendosni në një balancë investimin për kërkesat e studentëve, që këtu nuk administrohen, me çështjet e tjera që keni renditur?

Faleminderit!

Anila Denaj – Faleminderit!

Po e vijoj përgjigjen nga pyetja e dytë, nëse më lejoni.

Investimet nuk janë asnjëherë të mjaftueshme. Rëndësi ka që këto të jenë në koordinim me të gjitha planet, në të gjithë sektorët.

Meqë po flasim për paketën studentore, ky investim apo rialokim që u bëhet dy kampuseve universitare, nuk është i vetmi. Ne vijmë nga vendime të Këshillit të Ministrave të fundit të dhjetorit, të cilat kanë fleksibilizuar mjaftueshëm dhe kanë një ndikim me gati 2 miliardë lekë në buxhetin e shtetit, në raport me disa elemente, siç janë tarifat e studentëve, bursat... Ky është një impakt që duhet përmendur, edhe pse nuk është pjesë e aktit normativ, efektet e të cilit do të ndihen në vijim.

Ju bëtë një pyetje në raport me qasjen time në vijim. Unë i përmenda që në fillim të fjalës sime, edhe treguesit makroekonomike të vitit 2018, të cilët i listova në të gjitha parametrat, ashtu edhe objektivat për vitin 2019 e në vijim.

Kuptohet që të gjitha kërkojnë të shikojnë prioritetet, që shkojnë drejt rritjes së të ardhurave, (rritja e të ardhurave të këtij viti është e konsiderueshme dhe më e lartë se ajo e vitit të kaluar) dhe njëkohësisht në nxitjen e punësimit, nëpërmjet nxitjes së nismave për të sjellë investime të huaja dhe direkte, sikurse edhe për të harmonizuar dhe punuar për të përmirësuar më tej klimën e

biznesit. Këto janë procese, të cilat në vite kanë ndodhur, do të intensifikohen dhe besoj se do të ruajnë në balancë të gjithë parametrat makroekonomike të listuar në fjalimin tim në fillim.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Po, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Nuk është se dua të kapem pas ndonjë termi as pas ndonjë përcaktimi që dhatë ju, por do t’ju këshilloja që ta linit sa më shpejt konceptin që keni për objektivin tuaj kryesor që është rritja e të ardhurave. Nuk duhet të jetë si objektivi për një ministër Ekonomie dhe Financat rritja e të ardhurave, por duhet të jetë një ekonomi e qëndrueshme, ku biznesi ka besim, ku rinia ka besim për të qëndruar dhe për të punuar. Njerëzit nuk duan të dinë çfarë shifrash raportoni ju dhe çfarë shifrash mbledhni ju në buxhet, njerëzit duan se cila pjesë e kësaj rritjeje ekonomike, nëse ekziston, shkon për ta dhe preken prej saj. Prandaj ju bëj një sugjerim shumë miqësor që ta ndryshoni këtë koncept që keni, pasi është një koncept shumë i rrezikshëm, është një koncept aspak social, ashtu siç duhet të jenë normalisht politikat ekonomike të një qeverie.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Mesi.

Senida Mesi - Përshëndetje të gjithëve!

Së pari, më lejoni t’ju uroj suksese në një punë aspak të lehtë në një situatë ku stabiliteti makrofinanciar, që u diskutua, por në lidhje edhe me ndërmarrjen e të gjitha nismave për t’u dalë mbanë atyre objektivave edhe si maxhorancë, edhe si qeveri, por edhe ju si ministri!

Nuk kam një pyetje direkte. Më lejoni të mos bie në përsëritje në lidhje me ndryshimet e aktit normativ, ku përveç akomodimit të nevojave urgjente dua të vlerësoj një element shumë të rëndësishëm reformën administrative dhe territoriale, e cila për të disatin vit me radhë tregoi se ishte një nga reformat më të suksesshme të kësaj maxhorance. duke përfshirë ligjin “Për vetëqeverisjen vendore” apo ligjin “Për financat vendore. Në detaje kemi raportin, kemi të ardhura në pothuajse të gjitha bashkitë, edhe pse kemi një raport 11- mujor në lidhje me të ardhurat tatimore, taksat lokale apo dhe me pjesën e tatimfitimit mbi biznesin e vogël, ky është rezultat i një kontrolli dhe mirëmenaxhimi në lidhje me një qasje të tillë.

Rekomandimi im personal në lidhje me pjesën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të ishte për më tepër vëmendje për çështjet ekonomike.

Ju zoti Ministër adresuat në fjalën tuaj përmirësimin e klimës së biznesit dhe të sipërmarrjes. Për politikat fiskale apo edhe një rregullim më të mirë të tregut të punës, më lejoni ndoshta të kundërshtoj deri diku faktin e rritjes së të ardhurave ku një ministër i Financave nuk duhet të pretendojë, pasi unë mendoj se të ardhurat vijnë jo vetëm thjesht nga rritja e taksave, ne kemi provuar se nuk kemi rritur asnjë taksë.

Në fjalën e saj ministrja përmendi edhe rritjen e formalizimit. Unë mendoj se nëse ne i mëshojmë më fort rritjes së formalizimit, ku çdokush do të paguajë aq sa i takon dhe i takon të paguajë shumë më pak nga sa kishte taksa dhe tarifa deri para vitit 2013 besoj se një regjim i tillë dhe zero tolerancë për evazionin dhe formalitetin do të jetë një nga objektivat që mund të realizohet fare mirë. Sfida e ministrisë është thithja e investimeve të huaja direkte, ku besoj se me përmirësimin e klimës së biznesit kjo është një nga ato sfida që ministria me lidhshypin e ri duhet ta vendosë dhe ta ketë me prioritet.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

(Ndërhypje pa mikrofon)

Zonja Ministre, si procedurë, edhe unë kur isha ministër e merrja fjalën me leje nga ish-kryetari i Komisionit dhe e zbatoja. Unë e pyesja: “Kryetar, a mund të flas”? Ish-kryetari shikonte nga zonja Tabaku dhe me jepte leje të flisja.

Do të jetë kënaqësi të vijë këtu dhe të bashkëbisedoni siç kemi bashkëbiseduar me shumë butësi dhe me racionalitet.

Anila Denaj - E drejtë! Është për t’u mbajtur shënim.

Në vijim të dy diskutimeve dhe në fjalën time dua ta ritheksoj sigurimin drejt një pune, e cila në mënyrë sistematike do të kërkojë një qasje transparente ndaj menaxhimit të të ardhurave dhe rritjes së tyre, sikurse u komentua jo vetëm nëpërmjet paketave fiskale apo politikave fiskale, por edhe nëpërmjet intensifikimit të luftës kundër informalitetit, e cila ka një qasje pozitive në klimën e biznesit, në rritjen e konkurrueshmërisë së ndershme. Në vijim të fjalës së zonjës Mesi, në këtë aspekt mendoj se kjo vlen për t’u përmendur.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ka pyetje tjetër? Nuk ka.

Sipas procedurës kalojmë në diskutime.

Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku- I dëgjova më shumë vëmendje shifrat që prezantoi ministrja për ekonominë për vitin 2018, fatkeqësisht asgjë jashtë propagandës qeveritare.

Unë dua të theksoj disa shifra që vijnë nga raportet shtetërore, pasi opozita nuk ka institucione paralele që prodhojnë të dhënat. Fatkeqësisht besimi i biznesit në sektorët e ekonomisë nga raporti i fundit i nxjerrë nga Banka e Shqipërisë tregon se ka rënë me 1,2 pikë. Shqetësim është kur ky besim bie për tremujorë me radhë dhe për Ministrinë e Financave kjo duhet të jetë një nga fushat ku duhet të punojë, si dhe një kampanë alarmi. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh nga pesimizmi në ekonomi, nga mungesa e investimeve publike, nga fakti se sot bizneset paguajnë 9 miliardë euro më shumë taksa, e kanë të pamundur të investojnë për të ardhmen dhe e kanë të pamundur që të rrisin investimin.

I njëjti trend vihet re edhe te kreditimi i ekonomisë. Fatkeqësisht 11 - mujor me 11- mujor për ato të dhëna që kemi kreditimi i biznesit ka rënë me 180 milionë dollarë më pak se viti 2017. Ky është një tregues për të cilin ju duhet të merrni masa dhe lidhet me rënien e besimit në ekonomi.

Raporti i paraqitur nga DASH-i dhe shqetësimet e FMN-së lidhen me pyetjet që ju bëra pak më parë, me koncesionet dhe me partneritetin publik- privat që janë një kampanë alarmi për ekonominë shqiptare dhe fatkeqësisht ua kanë lënë juve këtë barrë. Janë shqetësim i madh, sepse nuk po llogaritim borxhin publik, shifrat e këtij të fundit që raportuat këtu nuk janë shifra të drejta, ashtu siç edhe raporti i KLSH-së gjeti në fund të vitit 2017 se në borxhin publik nuk ishin llogaritur TVSH-ja, lista për rimbursimin e TVSH-së, as detyrimet e prapambetura.

Në vitin 2013 kur erdhi kjo qeveri me propagandë të madhe për një shifër prej 175 milionë eurosh detyrime të prapambetura e ngriti dhe e bëri çështje ndërkombëtare, ndërkohë që ju nuk i llogarisni, por të paktën përdorni të njëjtin standard që përdoret në vitin 2013, nuk i llogarisni në borxh, nuk i merrni parasysh dhe nuk i raportoni as në shifrat publike që Ministria e Financave duhet të raportojë. Shqetësim i madh vazhdojnë të mbeten koncesionet e partneritetit publik - privat: 2,2 miliardë është llogaritur shifra.

Unë nuk e di nëse Ministria e Financave ka sot një regjistër për koncesionet. A e di se çfarë po i ndodh ekonomisë shqiptare? A ka një skedul pagesash? A ka një raportim të saktë se çfarë do të ndodhë çdo vit? Ne e kemi këtu të paktën për 3 vjetët e ardhshëm dhe e dimë që deri në vitin e tretë do të shkojë pothuajse në 160 milionë dollarë pagesa për koncesionet, por nuk kemi një regjistër të plotë të të gjitha detyrimeve dhe kontratave që janë nënshkruar dhe do të nënshkruhen.

Fatkeqësisht, akti normativ tregon edhe një herë atë që ne e kemi theksuar gjatë kësaj periudhe: mungesën e investimeve publike. Si të ardhurat dhe shpenzimet, fiskalet e 11- mujorit, ashtu edhe në aktin normativ tregohet se në 11 muaj qeveria shqiptare dhe Ministria e Financave ka ndenjur pa bërë asgjë. Nuk janë bërë investime publike. I keni bërë të gjitha në dhjetor. Jam e sigurt, por raporti i investimeve publike janar- nëntor 2018 ka një mosrealizim prej pothuajse 150 milionë dollarësh, duke e vendosur edhe një herë në pikëpyetje realizimin e investimeve publike me fonde buxhetore, që duhej të ishte në pikën e parë të rendit të ditës dhe prioritetëve tuaja si ministre.

Ne kemi ngritur shqetësim edhe për procedurat e tenderimit në Republikën e Shqipërisë pas raportit të auditit të BE-së: 30 % e procedurave realizohen pa tender, pa garë me prokurim të drejtpërdrejtë. Kjo ndikon edhe në koston e të gjitha projekteve të investimit. Nga një analizë që u kemi bërë të gjitha projekteve të Agjencisë së Rrugëve. 99,5% është kosto afër fondit limit. Kjo është një kosto shumë madhe për buxhetin e shtetit, për të cilin qeveria nuk ka marrë masa dhe jam e sigurt se nuk do të vazhdojë të marrë masa kushdo që do ta drejtojë atë ministri dhe çfarëdo që të ndodhë në atë ministri.

Njëkohësisht, kemi ngritur si shqetësim edhe disa nga zërat e shpenzimeve. Zonja Mesi, ju përmendët reformën territoriale dhe, meqenëse e keni ndjekur atë reformë, po ju them se, për fat të keq, është një dështim shumë i madh. Premtuat se do t'i ulni shpenzimet me 80 milionë euro, ndërkohë që janë rritur me rreth 60 milionë euro. Sado që bashkitë mund t'i rrisin të ardhurat, shpenzimet operative vazhdojnë të rriten dhe ky është shqetësimi i madh. Ju duhet të merrni parasysh se të ardhurat, taksat, tarifat e rritura të pushtetit lokal dhe të gjithë të ardhurat nga lejet e ndërtimit janë duke u përdorur për shpenzime operative dhe jo për investime. Në emër të opozitës unë kërkoj një informacion lidhur me raportin e ndarjes së Fondit të Zhvillimit të Rajoneve për bashkitë dhe për të parë zbatimin e projekteve në pushtetin lokal.

Së dyti, është ulur përsëri fondi i pagesave të papunësisë, ku me aktin normativ shkon pothuajse 3,5 milionë dollarë, ndërkohë që buxheti fillestar e parashikonte 8 milionë dollarë. Në aktin normativ të korrikut pagesat për ish- të përndjekurit politikë u ulën nga 20 milionë në pothuajse 10 milionë dollarë dhe zbatimi ka qenë i dobët, sepse e ndoqa muajin e kaluar, ku u bënë disa pagesa, të cilat nuk shkojnë kurrë drejt arritjes së objektivit, të paktën të asaj që keni vendosur në ligj. Për të bërë të gjitha pagesat e ish- të përndjekurve politikë me këtë ritëm që ju po i paguani ju duhen mbi 22 vjet, ndërkohë që po ulni shpenzimet për shtresën e ish-të përndjekurve politikë.

Viti 2018, fatkeqësisht, nuk solli asgjë të re në ekonomi, megjithëse vendosët TVSH-në për bizneset mbi 2 milionë lekë, megjithëse vendosët lehtësira fiskale për hotelet me 4 dhe 5 yje, ndërkohë që kishte një pabarazi shumë të madhe, sepse rritët barrën fiskale për bizneset e vogla. Fatkeqësisht, qeveria dështoi edhe me taksën e pronës, kur premtoi se do të ngrinte një *data base*, do të nginte një regjistër, një kadastër fiskale. Zoti Ministër ishte këtu, sepse e kemi thirrur ne, me kërkesën tonë, për të raportuar në lidhje me ngritjen e kadastrës fiskale, por, fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi.

Në pikën e dytë të rendit të ditës më e rëndësishme është se kemi një raportim, një kërkesë të bërë nga dy deputetë të Kuvendit për buxhetin e arsimit. Fatkeqësisht edhe për buxhetin e arsimit, megjithëse keni sjellë një akt normativ, që nuk rregullon dhe nuk përmirëson asgjë në thelb asgjë, nuk ka asnjë ndryshim në cilësinë e arsimit ose në kërkesat që kanë pasur studentët, me të cilët unë besoj se do të diskutojmë edhe në pikën e dytë të rendit të ditës. Të gjitha ato që paraqiten në aktin normativ janë thjesht rregullime, ulje dhe ngritje shpenzimesh dhe të ardhurash, për të rregulluar mangësitë në parashikimin që kishte bërë vetë ministria.

Në vitin 2018, kur ky buxhet erdhi, u tha se ishte buxheti më realist dhe se ishte buxheti më mirë i arritshëm, por, fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi, sepse përsëri u bënë dy akte normative.

Në vitin 2013 u tha se nuk do të përdoreshin kurrë aktet normative si instrumente. Fatkeqësisht, çdo vit kemi pasur dy akte normative si rregull. Asgjë që mund të ndryshonin këto akte nuk do ta sillnin në binarë ekonominë, sepse informaliteti është rritur dhe treguesit e ekonomisë janë këto që unë ju përmenda sipas raporteve tuaja zyrtare. Fatkeqësisht, mungojnë edhe investimet në sektorët prioritarë.

Unë do të marr të drejtën për të diskutuar për arsimin kur të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Zonja Ministre, unë e ndoqa me kujdes fjalën tuaj dhe vura re se krahasonit shifrat e vitit 2018 me ato të vitit 2017. Pra, kaq përqind qenkan rritur të ardhurat, shpenzimet dhe investimet krahasuar me një vit më parë. Në fakt, krahasimi nuk duhet bërë me një vit më parë, detyrimisht do të rriteshin, sepse nuk ka ndodhur ndonjëherë të mos rriten vetëm po të ketë krizë. Në qoftë se do të ishin më të ulëta se një vit më parë, do të thotë se jemi në krizë.

Krahasimi duhet të bëhet me planifikimin e vitit. Pra, nëse viti 2018 ka një buxhet, me të gjithë treguesit në fund, kur mbyllet viti 2018 e krahasojmë me parashikimet që kemi pasur. Për fat të keq, sikurse e tha edhe zonjë Tabaku, parashikimet ndryshojnë vazhdimisht, buxheti ndryshon, një herë e ndryshojmë në korrik, pastaj e ndryshojmë përsëri në muajt tetor-nëntor, kur miratohet buxheti i vitit të ardhshëm dhe më pas vjen dekreti ose në fund të dhjetorit, ose në fillim të janarit, që mbyll përfundimisht shifrat e vitit. Nëse ne do të krahasojmë shifrat me fillimin e vitit 2018, ato janë shumë më poshtë, por edhe me ato që quhen zyrtarisht treguesit e buxhetit të vitit 2018, përfshirë këtu edhe rishikimet e vitit 2018, që po na sillni janë poshtë me mosrealizime. Pavarësisht se rritja ekonomie është zyrtarisht 4,4% , ne duhet të jemi realiste dhe të themi se kjo rritje ekonomike ka ardhur nga investimet intensive në TAP, në hidrocentralin e Moglicës dhe nga shitja e energjisë elektrike, por nuk është rritje ekonomike që ka prodhuar punësim. Fakti që ne vazhdojmë dhe kemi emigracion masiv, do të thotë se në Shqipëri nuk ka zhvillim të qëndrueshëm, nuk ka vende pune për qytetarët, ndaj ata nuk sigurojnë dot të ardhurat dhe ikin. Ne jemi vendi me nivelin më të lartë të emigracionit në Europë dhe kjo duhet të na shqetësojë dhe të marrim masa për t'i bërë ballë, ndryshe këtu do të mbetet vetëm qeveria. Madje edhe Kryeministri do të jetë *part time*, sepse shpeshherë ikën për ekspozita.

Po t'i shikojmë të ardhurat në tërësi, unë kam shifrat e 11-mujorit, dhe të gjitha janë nën planifikim, 94 milionë dollarë, ku nuk realizohet TVSH-ja, nuk realizohet tatimfitimi, nuk realizohet akciza, nuk realizohen të ardhurat personale. Në këtë mënyrë rriten shpenzimet operative, sepse i keni të rritura. Në krahasim me parashikimin keni ulje në zërat e tjerë, rriten pagesat e papunësisë, investimet, zhvillimi rural, transporti rrugor, furnizimi me ujë, të cilët janë komponentë shumë të rëndësishëm që sigurojnë punësim. Nëse këto nuk marrin financimin e nevojshëm, atëherë shifrat, të cilat vijnë për arsye që nuk kanë të bëjnë me një zhvillim normal të zakonshëm, janë të përkohshme dhe ju do ta ndieni. Jo më kot ju thashë se ju kanë lënë në ditën më të keqe, sepse paralajmërimin ju kanë dhënë institucionet ndërkombëtare, si FMN-ja, se si do të veproni, çfarë mekanizmash do të gjeni, çfarë reformash strukturore do të ndërmerri, në mënyrë që në vitin 2019 të kompensoni efektin negativ nga përfundimi i TAP-it, hidrocentralet në lumin e Devollit apo konjuktura të tilla të favorshme, siç kishte viti 2018, ku kishte shumë reshje, u shit energjia elektrike dhe u siguruan të ardhura, por, megjithatë, nuk realizua plani. Ky është një shqetësim i madh.

Lidhur me borxhin, mos e besoni zotin Ahmetaj kur tha se është 7,3, sepse vetëm detyrime të fshehura janë 240 milionë euro të vitit 2018 të palikujduara, që nuk i ka përfshirë. Shikojeni pak më seriozisht edhe raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku flitet për fiktivitet të shifrave, domethënë që treguesit manipulohen. Nëse do të futeshin edhe detyrimet e prapambetura borxhi do të shkojë 72%. Kini parasysh se kemi edhe PPP-të, të cilat, zoti Ahmetaj, nuk i fuste në llogari, megjithëse FMN-ja insistonte që duhet t'i kishte futur në borxhin e përgjithshëm publik. Ndaj, nëse ai do të fuste këto miliarda nga PPP-të, borxhi i përgjithshëm publik do të shkonte te 80%-shi. Kur Davos-i tha se Shqipëria do të përballlet me një krizë fiskale, pikërisht për këtë gjë e tha. Nga grupi i vendeve që kanë risk në vitin 2019, Shqipëria ka riskun në treguesin më të rrezikshëm: krizë fiskale. Ne jemi të parët në listë për nga rreziqet dhe kjo duhet të tërheqë vëmendjen tonë, veçanërisht vëmendjen tuaj, që jeni drejtuese e re e kësaj ministrie, që të mos e merrni të mirëqenë çfarë ju kanë lënë, por të gërmoni dhe të shikoni ku janë të ngulura shtyllat në rrëzë, sepse këtë do ta vuajë ekonomia, do ta vuajnë qytetarët shqiptarë. Askush nuk do, as ne si opozitë nuk duam që të përsëritet një skenar si në Greqi, sepse njerëzit do ta vuajnë. Dëshira është një gjë dhe të vepruarit është një gjë tjetër. Ne vetëm fjalën kemi, ndaj ju paralajmërojmë, sepse për të vepruar do të veproni ju. Nëse nuk doni, atëherë është faji juaj.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Spaho!

A e do fjalën dikush tjetër për të diskutuar?

Jorida Tabaku – Kam vetëm diçka për të shtuar, zoti kryetar!

Unë dua të theksoj edhe një herë, shpresoj që të jetë një kërkesë e përbashkët për të dyja palët e komisionit, se dua një informacion lidhur me shpërndarjen e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve sipas bashkive. Nëse keni mundësi të na e vini në dispozicion ju, ose Ministria e Financave...

Arben Ahmetaj – Do t'i bëjmë një kërkesë Ministrisë së Financave.

Jorida Tabaku – Nëse ka mundësi, mund të bëjmë një kërkesë të përbashkët, që njëkohësisht të na dërgojnë informacion lidhur edhe me të ardhurat e TVSH-së, sipas fashave të bizneseve për të kuptuar si ka ndikuar vendosja e fashës te bizneset mbi 2 milionë tek të ardhurat e TVSH-së.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Besoj se sekretari i shënoi kërkesat e zonjës Tabaku.

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli - Urime, zonja Ministre, për detyrën!

Ju falënderoj edhe për prezantimin!

Unë nuk dyshoja që diskutimi i sotëm do të kishte karakter të dyfishtë, nga njëra anë, do të kishte karakterin e përqendrimit tek akti normativ, si një akt ligjor, që e dimë të gjithë se çfarë vlere ka dhe përse përdoret, dhe, nga ana tjetër, pa dyshim, nga akti normativ nuk mund të shmangej një diskutim për situatën ekonomike dhe fiskale, perspektivën e saj për vitin e ardhshëm dhe mbështetjen që politikat buxhetore u bëjnë prioriteteve të zhvillimit ekonomik të vendit. Edhe pse, siç e thashë, kemi të bëjmë me një akt, që është një akt pas faktit, madje ditën e sotme të diskutimit e kemi drejtuar pas një fakti të dyfishtë. Pse them të dyfishtë? Së pari, sepse akti normativ dokumenton dhe ligjëron veprimet e kryera deri në fund të vitit të kaluar, me qëllim sistemimin e situatës fiskale dhe përdorimin për më të mirë të fondeve të papërdorura në një periudhë të caktuar. Ky është akti normativ.

Së dyti, ky akt diskutohet në një kohë kur qeveria, Ministria e Financave, ka mbyllur edhe llogaritë e vitit të kaluar. Pyetja që shtrohet, të cilën e kemi shteruar edhe herë tjetër, edhe pse e ngremë dhe e diskutojmë këtu është: a duhen bërë akte normative gjatë vitit? Pra, edhe pse e kemi bërë këtë debat, përsëri të gjithë kemi rënë dakord, edhe kur ka qenë opozita në pushtet, edhe tani që jemi ne ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, kemi rënë dakord që aktet normative duhen parë nga qëllimi që kanë dhe çfarë sjellin ato. Aktet normative, në një vend si Shqipëria, por edhe si shumë vende të tjera, të cilat qëllimet e brendshme ekonomike dhe zhvillimet e jashtme japin ndikime gjatë një periudhe njëvjeçare, nuk mund të mos reflektohen. Pra, nuk mund të mos reflektosh ndikimin e kursit të këmbimit, i cili filloi të ndryshojë në qershor apo ku di unë dhe nuk mund të mos ndikosh influencat në marrëdhëniet ekonomike me vendet e rajonit që ne kemi. Pra, janë disa arsye dhe për më tepër përdorimi i fondeve me efektivitet në projekte që janë më me eficiencë është i domosdoshëm. Problemi shtrohet nëse këto ndryshime kanë çuar në përmirësim të situatës ekonomike-financiare apo kanë ndikuar për keq në treguesit makro-ekonomikë dhe ata fiskalë të zhvillimit të vendit në periudhën e vitit 2018. Fakti që ne kemi edhe një mbyllje të llogarive dhe një rezultat të paraqitur nga qeveria dhe Ministria e Financave, tregon se ndryshimet e bëra, sepse të gjitha këto që janë në akt janë realizuar, kanë ndikuar për mirë. Këto ndryshime kanë ndikuar për mirë, sepse nuk ndikuan për keq në rritjen ekonomike, përkundrazi kemi një rritje ekonomike të konfirmuar 4,2%.

Pra, nuk ndikuan për keq në deficitin buxhetor, nuk ndikuan për keq në balancën primare, nuk ndikuan për keq në borxhin publik bruto apo neto. Pra, në qoftë se këto nuk kanë ndikuar për keq këtu, atëherë, pa dyshim, që ne sot do të vazhdojmë të bëjmë pyetjen: pse e bëjmë një akt normativ? Sepse kemi bërë më të mirën e mundshme për të rregulluar dhe sistemuar situatën financiare në vend.

Po i kthehem anës politike–ekonomike, të cilën sa herë diskutojmë ndonjë akt normativ, pa dyshim, edhe ne, edhe ju, e shfrytëzojmë për të paraqitur, natyrisht, me të drejtë opinionin e tonë mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale në vend apo mbi disa politika ekonomike. Tani ju thatë që, edhe pse rritja ekonomike është 4,2%, kjo gjë vjen nga TAP-i, a thua sikur TAP-i bëhet në Gjermani. TAP-i në Shqipëri bëhet dhe shumë mirë që bëhet, sepse na jep atë rritje ekonomike, por kur të mbarojë TAP-i do të fillojë diçka tjetër. Rritja ekonomike vjen nga një hidrocentral? Shumë mirë që vjen nga hidrocentrali se në Shqipëri është. Nga duhet të presim ne rritjen ekonomike, sepse nga këto investime vijnë?!

Pika tjetër që u diskutua janë PPP-të, dhe shumë mirë që u hap diskutimi. Këtu u tha se në bazë të përvojës së krijuar PPP-të nuk janë shpikje shqiptare, ato aplikohen në shumë vende dhe këtë gjë e kemi diskutuar disa herë, por problemi është se si ne t'i aplikojmë sa më mirë që të japin ndikimin maksimal në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të mos na krijojnë probleme dhe shqetësime në menaxhimin e financave publike. Ne kemi një përvojë, e cila sapo ka filluar të japë disa rezultate, sepse është monitoruar i gjithë procesi dhe ka një reflektim në një ligj, i cili ka ardhur për të diskutuar në Kuvend dhe atë ditë që do ta diskutojmë do të shprehim edhe opinionet, mendimet dhe sugjerimet tona për ta përmirësuar sa më shumë. Unë besoj se nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta votojmë këtë akt normativ. Procedura e aktit nga pikëpamja Kushtetuese është: ose votohet, ose nuk votohet, sepse ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse konfirmojnë ato llogari që tashmë janë mbyllur nga qeveria.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Angjeli!

A ka diskutime të tjera?

Edmond Spaho – Kam unë.

Arben Ahmetaj – Po ju sikur e bëtë një herë diskutimin.

Edmond Spaho – Zoti Angjeli, iu referua atyre që thashë unë, ndaj kam një koment.

Arben Ahmetaj – Ne nuk jemi në seancë këtu, ndaj kjo nuk ka sens.

Edmond Spaho – Unë jam dakord me një pjesë të atyre që tha zoti Angjeli, sepse pikërisht edhe sensi i diskutimit tim ka të bëjë me realizmin për të parë se ku jemi me të vërtetë. Unë nuk e vë në dyshim që TAP-i bëhet në Shqipëri dhe nga kjo përfiton Shqipëria, por, pavarësisht kësaj, pavarësisht se kemi një rritje ekonomike, mua më shqetëson fakti pse po ikin njerëzit dhe pse njerëzit nuk po gjejnë punësim këtu?! Ky është shqetësim i madh, sepse po vazhdojnë dhe ikin si në vitet '90. Pse nuk ka rritje pagash dhe pensionesh kur paskemi një rritje ekonomike kaq të lartë, sepse 4,2% është një rritje e lartë ekonomike?! Kjo ndodh sepse nuk ka para. Pra, paskemi rritje ekonomike, por kemi mungesë parash që nuk po rriten pagat dhe pensionet?! Kjo ndodh sepse nuk ju nuk i keni realizuar të ardhurat në krahasim me planin. Po kështu nuk i keni realizuar edhe shpenzimet në të gjitha zërat që krijojnë punësim dhe ky është shqetësimi im. Shqetësohem, për shembull, pse studentët tanë kanë dy muaj që janë në protestë kur paskemi këtë rritje ekonomike dhe paskemi lekë pafund?! Pse nuk u plotësohen kushtet atyre?! Pse u rriten tarifat studentëve në vend që t'u ulen?! Këto janë shqetësimet tona që duhen drejtuar.

Arben Ahmetaj - Zoti Spaho, ky është diskutimi juaj i dytë sipas procedurës...

Edmond Spaho – Të lutem!

Ju thoni që keni ulur borxhin, por mua më shqetëson kjo gjë. Ti fshihesh pas rënies së kursit të këmbimit, sepse nesër, nëse do të fillojë kriza fiskale, gjë të cilën po e parashikojnë, euro do të shkojë 140 lekë, atëherë do të shikosh që borxhi publik do të rritet edhe 2 apo 3% më shumë. Pra, këto janë shqetësime, ndaj të mos kapemi nga faktorë të momentit dhe të ngremë flamurin e fitores, por të merremi me faktorët afatgjatë. Edhe Kryeministri i Greqisë në fillim të viteve 2000 kështu bëri, i cili organizoi edhe lojërat olimpike, por barrën në kurriz ua la të gjithë qytetarëve, të cilët e vuajtën edhe 15 vjet të tjera.

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Spaho!

Para se të kalojmë në votim, dua të shpreh edhe unë qëndrimin tim.

Zonja Ministre, faleminderit për të gjithë ekspozenë që bëtë për zhvillimet fiskale dhe ekonomike të vitit 2018.

Dua të theksoj që arritja fiskale e vitit 2018 është rekord, sepse deficitit është 1.6% e prodhimit të brendshëm bruto, i cili është më i ulëti në histori.

Këtu u tha se nuk ka pasur ndonjë moment ku të kenë rënë të ardhurat nominalisht. Unë ju korrigjoj, sepse janë vitet 2011, 2012 dhe 2013, ku të ardhurat tatimore kanë rënë nominalisht, sidomos në vitin 2012. Pra, kanë njohur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mondi, a mund ta mbaroj? Të lutem mos më ndërprit, sepse nuk të ndërpreva. Përrallat i dëgjuam nga ti.

E dyta, borxhi publik i konfirmuar edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili ka deklaruar në deklaratën që shoqëron raportin e stafit se borxhi publik bruto është 67.2% e prodhimit të brendshëm bruto dhe borxhi neto është 63.9%. Ky është rekordi më i ulët. E latë me 73.4% dhe sot është 10 pikë më pak.

E dyta që është shumë e rëndësishme, në fund të vitit 2018 mbledhen 1.2 miliardë dollarë më shumë sesa viti 2013, ndërkohë që kemi ulur taksat, duke filluar me biznesin e vogël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti je në konflikt interesi me shqiptarët ndërsa unë jo. Unë po them se biznesi i vogël tatohet me 0% dhe me 5%. Pra, tatohen 91% e bizneseve, që janë 93 mijë sipërmarrje, të cilat paguajnë ose 0% ose 5% e tatim fitimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ekonomia është rritur dhe është më e larta në rajon. Në tremujorin e tretë është 4.4%. Pra dëshira e opozitës për t'u ngritur mbi hirin e skenarit grek, të cilën e kanë thënë në vitin 2013 dhe e përsërisin çdo tremujor, por çdo tremujor rritja ekonomike del me mbi 4.3 dhe mbi 4.4%, që është rekord në rajon.

Konsumi është rritur me 3.86%, përsëri është rekord në 10 vjet. Ndërkohë që këta vazhdojnë këngën e qyqes për t'u kufizuar te SHQUP-i.

Vazhdojmë me rritjen e eksporteve. Ekonomia paska rënë, por eksportet janë rritur me 15%. Kjo do të thotë, në kursin e këmbimit, kur leku është mbivlerësuar dhe ndërkohë që eksportet janë rritur, specifikisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë e ke këtë zakon, se je goxha burrë? Nuk ka sens që kur unë flas, flet edhe ti kot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju nuk jeni kakofoniku i grupit, por kryetari. Ju lutem mos më ndërprisni se nuk ka sens.

Pra, kur leku është mbivlerësuar dhe eksporti është rritur, kjo tregon se në ekonomi ka konkurueshmëri dhe produktivitet më të lartë. Sigurisht që diskutimi se ku jemi dhe sa kemi për të bërë e të tjera do të vazhdojë, por në fakt ky është edhe thelbi i debatit.

Për sa i përket paketës fiskale, dua ta them këtu se çdo vit ka pasur ulje taksash dhe zgjerim të paketës fiskale. Ulje taksash iu referova biznesit të vogël, bujqësisë dhe turizmit. Pra, taksa progresive është në themel të politikës së kësaj maxhorance dhe do të vazhdojë të jetë, pra kush fiton më shumë do të paguajë më shumë.

A e dini se sa është llogaria? Që të mos thoni përralla shifrash, bëni një hetim parlamentar dhe shkoni në thesar ku të verifikoni përrallën tjetër. Nëse doni, aty e keni thesarin dhe llogaritë. Një pjesë juaja e di sesi funksionon thesari, ndërsa një pjesë tjetër që nuk ka prekur punë me dorë, nuk e di dhe nuk kam se çfarë t'u bëj, pra mund të verifikoni se çfarë thotë thesari edhe për borxhin, për deficitin dhe të gjitha parametrat e tjerë.

Iu referuat rritjes së pagave dhe pensione. Mund t'ju bëj një llogari, në 8 vjet ju keni bërë rritje pagash rreth 9 miliardë lekë, kurse kjo mazhorancë në 4 vjet ka bërë rreth 11.6 miliardë lekë. A doni t'ju tregoj një tjetër, meqenëse i referoheni ekonomisë dhe skenarit grek, i cilin ju e latë në vitin 2012, ku ishte edhe kulmi i varfërisë? Raporti i Bankës Botërore flet për përmirësimin e situatës ekonomike që vjen nga punësimi dhe të regjistruara me gjithë sektorin bujqësor janë rreth 262 mijë vende të reja pune.

Unë e kuptoj shumë mirë këngën e qyqes që duhet ta mbani, por, kur u referoheni financave publike, referohuni të dhënave të thesarit. Për informacion, 12 mujori i vitit del zyrtarisht në mars, por i keni të botuara në vazhdimësi edhe në *website*-in e Ministrisë së Financave, mjafton të klikoni.

Për sa i përket pjesës sociale, mos harroni që ju u hoqët bukën e gojës qytetarëve me aftësi ndryshe. Pra 4.4 miliardë lekë, ua hoqët në vitin 2013. Imagjinoni njerëz në nevojë dhe me aftësi ndryshe që iu grabitën 4.4 miliardë lekë, pra 44 milionë dollarë dhe flisni ju për të ardhurat.

Dëmi nga kursi i këmbimit është 9.6 miliardë dhe ju flisni nëse do të bëhet apo jo akt normativ. Mendje është kjo? Të vish në Komisionin e Ekonomisë dhe të diskutosh nëse do të bëhet apo jo...

Ministre, sa herë që të duhen akte normative në favor të përmirësimit të situatës, pra sa herë që t'i duhet qeverisë, do të na kesh në dispozicion. Ç'është ky diskutim? Diskutohet procedura parlamentare ka apo nuk ka. Kjo i bie të kthehemi 10 vjet mbrapa.

Te paketa e solidaritetit, edhe këtu ka një krahasim, në 5 vjet ne u kemi dhënë pensionistëve dhe të gjithë grupit të ndihmës ekonomike rreth 25 milionë dollarë më shumë sesa i keni dhënë ju në 8 vjet. Unë jam i bindur që do të vazhdojë me këtë politikë për paketën e solidaritetit, e cila do

të shkojë 22 miliardë lekë në 8 vjet. Kjo do të thotë se është dyfishi i asaj që ju keni dhënë në 8 vjet dhe mos harroni se kjo së bashku me indeksimin e pensioneve e çon rritjen e pensioneve, meqenëse iu referuat, në 4.5%.

Pagat e sektorit publik, vetëm në këtë vit, kanë pësuar rritje për 64 mijë punonjës të administratës publike, si për mësuesit, infermierët, diplomatët, mbrojtja, e të tjerë. Kjo do të thotë që situata fiskale financiare jo vetëm që është shumë e përmirësuar, por është e konsoliduar.

Meqë i referoheni mënyrës sesi kontabilizohet partneriteti publik privat, këtë diskutim e kemi bërë kur unë kam qenë në atë pozicion dhe ju kam treguar se çfarë ka thënë Fondi Monetar Ndërkombëtar: “Është instrument i rritjes së investimeve publike”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë duhet t’i ndiqni, ka qenë në konferencë shtypi me ministrin e Financave për artikullin 4. Mund të kërkonit në arkiva dhe ta nxirrni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta keni qenë në protestë dhe nuk e keni parë.

Vazhdojmë me partneritetin publik privat, i cili është një instrument, që në mënyrë të shëndetshme do të përdoret nga qeveria. E gjithë bota e përdor. Ne kemi vendosur në ligjin organik të buxhetit kufizimet fiskale për partneritetin publik privat.

T’u them qytetarëve se për çfarë jemi duke folur. A i shikoni këto, të cilët demonizojnë koncesionet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga 283 koncesione, 218 i kanë bërë këta. A doni të dini për koncesionet e energjisë? Po ju jap një shifër për dëmin që i shkon OSHE-së, vetëm për vitin 2018 nga koncesionet e hidrocentraleve ka qenë 39 milionë euro. Dikush nga qytetarët mund të pyesë se farë do të thotë kjo. Por unë po i përgjigjem pa më pyetur, çmimi i negociuar për hidrocentralet private shkon në kurrizin tuaj, të nderuar qytetarë, duke goditur OSHE-në, pra vetëm në vitin 2018 dëmi ka qenë 39 milionë dollarë.

A e mbani mend koncesionin e skanimit? 40 euro një deklaratë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku e keni parë, është në hetim në SHBA.

Pra, 40 euro një deklaratë. Për ta ndërprerë do të duhet të paguanim, qytetarët së bashku me buxhetin e shtetit, 280 milionë euro për galletën e tyre. Çfarë bëmë? Ne e ulëm. A e dini sa

është dëmi? Buxheti i shtetit paguan për skanimin 19 milionë dollarë në vit dhe këta diskutojnë për koncesionet. Kjo do të thotë që të sëmurët me dializë të mos ta përfitojnë këtë shërbim, ashtu siç e përfitojnë sot në zona shumë afër banesave të tyre dhe me efektivitet. Kjo do të thotë që sterilizimi të mos ndodhë dhe Rruga e Arbrit të mos të bëhet. Ka standarde ndërkombëtare sesi kontabilizohet borxhi. Përrallat janë histori tjetër.

Viti 2018 mbylli një diskutim shumë të gjatë për borxhin publik, sepse e konfirmoi vetë Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili tha se borxhi publik bruto është 67.2% dhe ai neto është 63.9%. Që ta sqaroj për qytetarët, bruto do të thotë me të gjithë paratë që ka qeveria në llogarinë e vetë për shkak të eurobondit.

Eurobondi ishte një test shumë i rëndësishëm për ekonominë shqiptare dhe doli me shumë sukses. Për hatër të Shqipërisë duhet ta kishit thënë një fjalë të mirë, por nuk ju vjen në gojë.

Për ta mbyllur diskutimin, jua kam thënë në çdo komunikim publik se çfarë është balanca primare? Balanca primare, e kam për qytetarët, është nëse një qeveri krijon apo jo një borxh të ri. Kur balanca primare është negative, do të thotë që qeveria ka krijuar borxh të ri; kur ajo është pozitive, si në rastin konkret të vitit 2018 me 0.6%, do të thotë se qeveria jo vetëm që nuk ka krijuar borxh të ri, por ka shlyer borxhin e vjetër.

Edhe një herë, Ministre, ju uroj suksese dhe faleminderit për prezantimin!

Kalojmë në votimin e aktit normativ. Kush është pro? Kundër? Jeni kundër paketës së solidaritetit për pensionistët? E kuptova. Abstenim? Një votë.

Miratohet akti normativ dhe i kalohet seancës.

Faleminderit!

Faleminderit Ministre, mund të vazhdoni, punë të mbarë!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.01.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për buxhetin e vitit 2019””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Vullnet Sinaj, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Edmond Haxhinasto, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj dhe Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Agron Shehaj, Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Anila Denaj - Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Suzana Stefa – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi - drejtor

Kejdi Mehmetaj – deputete

Floida Kërpaçi – deputete

Arben Ahmetaj – Kalojmë te pika e dytë. Ka një projektligj të LSI-së, pra të zonjës Mehmetaj, por si procedurë duhet t'i kërkohej mendim qeverisë, megjithatë unë mendoj të bëjmë një diskutim në mënyrë që të mos e përsërisim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Mehmeti, mund të bëni një ekspozitë të propozimit tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Kryetar, procedura parlamentare është e tillë: propozimi i deputetëve duhet të kishte shkuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe ata duhet të na kishin kthyer përgjigje, pastaj të diskutonim me përgjigjen.

Arben Ahmetaj – Ne mund ta shtyjmë.

Jorida Tabaku – Nuk po kërkoj ta shtyjmë, por po pyes: a ka një përgjigje nga qeveria, sepse Ministria e Financave iku dhe nuk e dëgjuam?

Arben Ahmetaj – A mund ta bëjë propozimin, zonja?

Jorida Tabaku – Jo, sepse duhet ta kishim edhe raportin e Ministrisë së Financave.

Arben Ahmetaj – Do ta kemi.

Jorida Tabaku – Kur do ta kemi, sepse sot është në rend dite?

Arben Ahmetaj – E para, sot do ta diskutojmë.

Jorida Tabaku – Nuk është kjo procedura.

Arben Ahmetaj – Nuk bën akt normativ parlamenti, është propozim për ndryshim ligjor.

Jorida Tabaku – Nuk thashë unë që është akt normativ.

Arben Ahmetaj – Ju thatë që është akt normativ.

Jorida Tabaku – Unë thashë se zoti Spaho po nënkupton që ky propozim të kthehet në akt normativ.

Arben Ahmetaj – Përse duhet të nënkuptojmë, kur mund ta kuptojmë drejtpërdrejt?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem prezantoheni propozimin dhe pastaj të vazhdojmë.

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Besoj se është e qartë natyra e propozimit tonë edhe për faktin se po atë ditë ne kemi bërë edhe një propozim paralel për ta shqyrtuar me procedurë të përsheptuar këtë projektligj dhe e kemi shprehur edhe në seancën e asaj dite. Propozimi që kemi për të shqyrtuar sot, edhe pse mbështes kolegen Tabaku, e cila tha që duhet të kishim edhe mendimin e qeverisë për të diskutuar paralelisht për hapësirat dhe pretendimet e saj për realizimin e këtij amendimi, është bërë në datën 12 dhjetor, pra në ditën e 8-të të protestës së studentëve, për të cilën jemi të gjithë dëshmitarë që ka qenë një nga protestat më domethënëse dhe më madhështore, si në numër ashtu dhe në mesazh, që ka parë Shqipëria në vitet e fundit.

Si dy deputete të reja në moshë të këtij parlamenti, ndërkohë që edhe vetë kemi qenë studente, gjykuam që të ishim ne ndërmjetësuesit dhe ura e komunikimit e atyre mijëra studentëve, që vërshuan përpara Ministrisë së Arsimit dhe parlamentit për të zgjidhur një ngërç që vazhdon edhe sot. Pra, diskutimi vjen 1 muaj e gjysmë pas ditës së parë të protestës së studentëve për realizimin e 8 kërkesave, të cilat janë pranuar publikisht që janë legjitime. Ndoshta nuk do të kishte një ditë më të mirë se kjo, sepse jo më larg se para disa minutash në Fakultetin e Drejtësisë është afruar ambulanca për një grup studentësh që vazhdojnë bojkotin, sepse janë të ftohur dhe me temperaturë. Kjo vjen pas gjithë atyre ditëve të pafund të protestave dhe fjetjeve në ambiente të ftohta, sepse qeveria ka arritur deri në atë pikë sa u ka ndaluar ndezjen e ngrohëseve për studentët dhe sot merren me ambulancë për në urgjencë, sepse përballë kanë një qeveri që nuk është e gatshme t'u përgjigjet kërkesave të tyre, madje akoma edhe më keq t'i trajtojë ata me arrogancë edhe me përçmim. Prandaj mendoj se nuk ka ditë më të mirë sesa kjo që ne dhe ju në radhë të parë të reflektojmë për të realizuar sa më parë kërkesat e studentëve, në mënyrë që sa më parë ata t'u kthehen auditorit dhe të marrin atë që duhet dhe u takon nga ky shtet, që është një shërbim maksimal dhe në funksion të tyre.

Konkretisht, propozimi ynë qëndron në dyfishimin e zërit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në buxhetin e shtetit. E thënë me shifra, ju e keni përpara, po e them me përafërsi nga 0,46% që zë arsimit të lartë dhe kërkimi shkencor ndaj prodhimit të brendshëm bruto, kemi propozuar të shkojë rreth 1% në krahasim me prodhimin e brendshëm bruto zëri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke kapur vlerat për arsimin e lartë rreth 14 miliardë e 909 milionë e 916 mijë lekë dhe për kërkimin shkencor 1 miliard e 240 milionë lekë. Këto para, ky fond ose kjo shtesë në buxhet do të shërbejë, në radhë të parë për të përgjysmuar tarifat e studentëve, pse jo për të shtuar bursat që jepen ndaj tyre, qoftë për studentët e ekscelencës, qoftë për studentët që

vijnë nga familje në nevojë apo që trajtohen për arsye të ndryshme në mënyrë preferenciale nga stafet e universiteteve për të marrë dhe për të pajisur studentët me kartën e studentit, që është një nga kërkesat e tyre kryesore, por paralelisht edhe një nga detyrimet e ligjit “Për arsimin e lartë” që duhet të kishte filluar realizimin që në vitin 2015, për të mbështetur kërkimin shkencor, për të përmirësuar bibliotekat, kushtet, për t’u dhënë më shumë hapësira qoftë studentëve, qoftë pedagogëve që ata të marrin arsim cilësor, ashtu siç në të vërtetë e meritojnë ata që i dhanë një mësim shumë të mirë, qoftë klasës politike shqiptare, qoftë edhe qytetarëve.

Nga ana tjetër kemi propozuar një fond të ri specifik, të cilin ne e kemi quajtur “fondin e emergjencës në arsim”. Për të mos e përsëritur ju gjatë pyetjeve apo diskutimeve tuaja, nuk ka ngjashmëri apo lidhje me fondin e emergjencave të parashikuar në buxhetin e shtetit, por për shkak të natyrës, kërkesës, momentit dhe emergjencës që ka rishikimi komplet i kushteve në të cilat jetojnë studentët, siç është rasti i konvikteve studentore, e quajtmë “fondi i emergjencës në arsim”. Ne gjykojmë se ky fond prej 5 miliardë lekësh do të ishte një fillim shumë i mirë për të ritrajtuar në mënyrë tërësore të gjitha konviktet, të gjitha banesat e studentëve, sepse ashtu si edhe ju i keni parë dhe keni qenë dëshmitarë të atyre që vetë studentët na kanë thënë, na kanë treguar, në konviktet tona përtej *show*-ut, fasadës që Kryeministri bën herë pas here me disa kamera dore që vetëm ai e di se ku ndodhen ato hapësira, realiteti është krejt ndryshe. Studentëve u bien suvatë në kokë, nuk kanë ujë të ngrohtë, janë në një kat 400 studentë që frekuentojnë një apo dy ambiente të përbashkëta për të kryer nevojat e tyre personale, mungojnë kushtet minimale të ngrohjes, shpërthejnë prizat, aksidente të herëpashershme kanë ndodhur në konvikte.

Unë dua të përfitoj nga kjo mundësi që na dhatë sot, edhe një herë të kthej në vëmendjen tuaj dhe t’ju kërkoj që të distancoheni nga sjellja që qeveria ka treguar deri tani nga ata mijëra studentë që kanë protestuar dhe vazhdojnë të protestojnë, të ktheheni me këmbë në tokë, të mendoni për ta siç do të mendoni për fëmijët tuaj, të kërkonit për ta të njëjtat kushte që kërkonit për shkollimin e fëmijëve tuaj dhe të merrni një hap që do të na bënte të gjithëve të ndiheshim dhe të ishim me dinjitet përpara studentëve dhe të rrisim buxhetin për arsimin! Kjo është e vetmja formë dhe asnjë formë tjetër mashtrimi apo gënjeshtre për të realizuar 8 kërkesat dhe për të kthyer studentët në auditor.

Faleminderit!

Po ia kaloj fjalën koleges sime.

Arben Ahmetaj – Më falni! Edhe ju do të bëni prezantimin për të njëjtën gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi - Ju nuk mund ta parashikoni se çfarë do të flas. Ju lutem, më lini hapësirën time për të folur!

Arben Ahmetaj – Pyeta, rri e qetë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dini ju?

Kejdi Mehmetaj - Zoti kryetar, sapo e thashë...

Arben Ahmetaj - Zonja Mehmetaj, flisni me leje. Për të njëjtën gjë, apo jo?

Floida Kërpaçi – Jemi të dyja bashkëpropozuese.

Përshëndetje!

Ashtu siç e prezantoi kolegja, amendamenti që sot keni përpara për ndryshime në ligjin “Për buxhetin e vitit 2019” u jep zgjidhje reale kërkesave të studentëve.

Studentët jetojnë një realitet që asnjëri prej jush që prej vitesh jeni tashmë në pushtet, nuk ka ndërhyrë, jetojnë realitetin e tarifave të larta të studimit, jetojnë realitetin ku konviktet janë në kushtet e tyre më të mjerueshme, ku infrastrukturat janë në mjerim, ku kërkimi shkencor nuk mbështetet dhe ku pamundësia ekonomike për ta dhe për familjet e tyre është jashtëzakonisht e vështirë për t’u përballuar.

Dëgjova pak më parë këtu në komision se është rritur ekonomia, një delir ekonomik i jashtëzakonshëm, kemi një rritje shumë të madhe në Shqipëri, por në fakt situata realisht është se 79% e shqiptarëve dhe e të rinjve janë të pushpresë dhe duan të largohen nga Shqipëria. Sipas FMN-së borxhi publik rezulton 83% të GDP-së, pra jemi në një situatë kaosi, në një situatë ku ju thoni: “ Është rritur ekonomia”, por në fakt ju nuk keni lekë për të mbështetur kërkesat e studentëve. Pra, është një situatë që të gjithë studentët, të rinjtë, qytetarët e kuptojnë. Jeni mësuar të bëni fasada dhe t’i mashtroni qytetarët, të rinjtë me konvikte 3D. Ata e dinë sesi jetojnë aty, nuk jetojnë me video 3D. Jeni mësuar t’i mashtroni se ka rritje ekonomike, por studentët e dinë se sa e vështirë është të përballojnë tarifat e larta. Jeni mësuar të gënjeni se keni gjetur zgjidhjen e kërkesave të studentëve, por sot është dita e 55- të e protestës së tyre dhe nuk është gjetur asnjë zgjidhje.

Jorida Tabaku- Zoti Angjeli, për procedurë, se zoti Ahmetaj mungon.

T’i japim kohë zonjës ta dëgjojmë, sepse unë e kam të pamundur të dëgjoj nëse të gjithë bisedojnë.

Flolda Kërpaçi - E kemi dorëzuar kërkesën në ditën e 8-të të protestës së tyre dhe sot është dita e 55-të.

Të dashur qytetarë, shikoni se çfarë neglizhence është treguar nga qeveria për zgjidhjen e kërkesave të studentëve. U mbledhëm në seancë të jashtëzakonshme për miratimin e 8 ministrave, ndërsa për të miratuar hyrjen me procedurë të përshpejtuar të këtyre dy amendamenteve që u jepnin zgjidhje konkrete kërkesave të studentëve nuk kishte kohë. Qeveria ishte shumë e zënë me lukset, me fasadat dhe me *show-n* drejtuar studentëve.

Megjithatë, ndërkohë që taksat janë rritur dhe ekonomia është në mjerim për familjet shqiptare, këtë e thotë realiteti dhe se si jetojnë familjet shqiptare, pyetja ime është: ku shkojnë paratë e shqiptarëve që sot nuk kemi lekë për ta çuar buxhetin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor nga 0,46 në 1%? Kaq pak kërkojnë studentët për realizimin e kërkesave të tyre, kur ndërkohë kemi 126 milionë euro që askush nuk e di se ku janë këto lekë. Është e qartë, unë do të kërkoj një distancim nga ana juaj dhe mendoj se dita e sotme dhe këto amendamente janë një vijë ndarëse ndërmjet atyre që vërtet i suportojnë kërkesat e studentëve dhe atyre që mbajnë anën e fasadave, të *show-ut* dhe nuk duan, nuk kërkojnë të gjejnë zgjidhje reale të kërkesave.

Kërkesat e studentëve janë shumë të thjeshta: kërkojnë të ulen tarifat, të rregullohen kushtet në konvikte, kërkojnë të keni infrastruktura më të mira në fakultete, të kenë një bibliotekë të aksesueshme, mbështetje për kërkimin shkencor, janë gjëra minimale.

Kërkohet vullnet dhe gatishmëri për t'i mbështetur këto kërkesa, që nga ana juaj, e qeverisë është treguar një neglizhencë totale. Sot në këtë komision është momenti për të treguar se kush është me studentët, kush i mbështet ata, kush voton dhe është kundër këtij amendamenti që i jep zgjidhjen reale dhe konkrete realizimit të këtyre kërkesave të studentëve.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj- Faleminderit!

Fjalën e ka relatorja, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Pa dashur të zgjatem më shumë te pjesa e përmbajtjes së projektligjit që ka të bëjë në mënyrë të posaçme me rritjen e shpenzimeve për arsimin e lartë universitar, për kërkimin shkencor dhe krijimin e fondit të emergjencave, po jap disa mendime për projektligjin, duke qenë se ky projektligj parashikon rritjen e shpenzimeve buxhetore për arsimin dhe shkencën. Pra, pavarësisht listës së dëshirave që mund të ketë gjithsecili nga ne si deputet, kërkohet që të respektojmë edhe pjesën e procedurave parlamentare. Në rastin konkret vlerësoj

maksimalisht dëshirat që kanë dy koleget e opozitës, por ndërkohë duhet që në relacionin që kanë sjellë të parashikohen se cilat janë mbulimet e shtesës së shpenzimeve buxhetore që kanë propozuar. Duke qenë se në këtë lloj projektligji nuk ka asnjë informacion të tillë, sipas nenit 82 të Kushtetutës, pa dashur këtu të bëjmë politikë, por mbi të gjitha të bëjmë detyrën që kemi si deputete të zgjedhura, theksohet: “1.Propozimi i ligjeve kur është rasti, duhet të shoqërohen kurdoherë me raportin që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. 2.Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit. 3.Nëse Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme”.

Për sa i përket këtij fakti do të doja edhe një mendim të dytë që ka të bëjë me atë se ky projektligj kërkon të adresojë një sërë problematikash që tashmë janë adresuar nga grupi i punës i ngritur nga Kryeministri për paktin me universitetin, ku jo vetëm të 8 kërkesat që kanë pasur studentët, (përsëri ju falënderoj që ju jeni një zë dhe i sillni, por ndërkohë grupet e punës janë ngritur në bashkëpunim dhe në dialog me studentët) por shumë më tepër sesa ato janë adresuar tashmë dhe janë të formalizuara në vendime të Këshillit të Ministrave dhe kanë filluar të japin efekt që nga data 1 janar i vitit 2019.

Gjithashtu, me masat që janë ndërmarrë për subvencionimin nga buxheti i shtetit me shpenzimet tarifore të studentëve do të doja të përmendja disa prej tyre, që kanë filluar të japin rezultate.

Së pari, të gjithë ata studentë që janë me ndihmë ekonomike, ata që kanë aftësi të kufizuara, para dhe tetraplegjikët marrin financimin e plotë 100% të tarifës dhe do të përfitojnë dhe një bursë studimi me 10 mijë lekë. Të gjithë ata studentë që janë ekselentë apo me mesatare mbi 9 në çdo program studimi do të përfitojnë nga qeveria mbulimin 100 % të tarifës së regjistrimit dhe nga tarifa e plotë që ata paguanin para këtij vendimi. Po kështu, në çdo program studimi ata do të përfitojnë një bursë studimi me 10 mijë lekë. Ndërkohë, deri sot bëhet fjalë për një përfitim prej 8100 lekësh vetëm ata që ishin me mesatare 10. Kjo e zgjeron ndeshëm gamën dhe mbështetjen e qeverisë për studentët më të mirë. Të gjithë studentëve do t'u paguhet 50% tarifa e studimit, drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit në pranimin në universitet. Deri para këtij vendimi paguanin

tarifën e plotë të këtij regjistrimi. Të gjithë studentët aktualë për pjesën e mbetur të vitit akademik dhe ata me notat të ulëta, pra 5 nuk do të paguajnë, por do të paguajë buxheti i shtetit për ta.

Në vitin e ardhshëm akademik të gjithë studentët që nuk do të jenë me mesatare 6 e sipër do të humbasin mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit.

Për sa i përket nivelit të dytë të studimeve, do të përfitojnë 50% të uljes së tarifës të gjithë ata që kanë një notë mesatare, pra për të mbështetur të gjithë ata që janë ekselentët në hyrje, studentët me ndihmë ekonomike, të verbrit, para dhe tetraplegjikët, ata që kanë statusin e fëmijës jetim, fëmijët e policëve të vrarë dhe të gjitha grupet e tjera vulnerabël të përcaktuara në vendim. Të gjitha këto masa kanë filluar të japin efekt që nga 1 janari i vitit 2019.

Përveç lehtësirave tarifore qeveria shqiptare ka ndërmarrë masat dhe vendime dhe ka formalizuar të gjithë vullnetin politik. Disa masa të tjera kanë të bëjnë me shqetësimet që ju keni ngritur, por mbi të gjitha i kanë ngritur studentët që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre. Janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet qeverisë shqiptare, qeverisë gjermane dhe qeverisë franceze, të cilat janë në investime konkrete në kampuset universitare. Për herë të parë në Universitetin e Tiranës po bëhet një investim i tillë.

Nuk po përmend këtu edhe një sërë masash që kanë të bëjnë me mbështetjen për kërkimin shkencor, për përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve, po të vazhdojmë kështu do të ishin shumë e shumë të tjera, por ajo që vlen për t'u përmendur është fakti që efekti që kanë të gjitha këto masa në mbështetje të kërkesave të studentëve qoftë në pjesën e përmirësimit të kushteve, infrastrukturën mësimore dhe ku ata jetojnë, pjesa e konvikte arrijmë me një shifër që shkon mbi 1.96 miliardë. Kjo është shtesë në buxhetin për arsimin. Të gjitha këto janë parashikuar dhe kanë filluar të japin efektin që nga 1 janari i vitit 2019.

Për sa më sipër pa dashur të zgjatem më tutje i propozoj komisionit që ta miratojmë për ta çuar për mendim në Këshillin e Ministrave, për të marrë mendimin nga ky i fundit, për sa kohë ka një efekt buxhetor.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku - Së pari, falënderoj dy zonjat për propozimin që kanë bërë!

Zonja Gjylameti e lexoi shumë qartë procedurën parlamentare. Në fakt, procedura parlamentare nuk lidhet me zonjat, ato e kanë depozituar në datën 12 dhjetor. Parlamenti duhet

të kishte marrë masat dhe ta çonte në qeveri. Sot ka kaluar pothuajse 1 muaj e gjysmë dhe ne si komision nuk kemi pse ta miratojmë që ta çojmë në qeveri, automatikisht procedura, Rregullorja e parlamentit duhet ta kishte çuar për të parë efektin financiar dhe se ku mund të bëhen rregullimet e nevojshme.

Unë e kuptoj që ka një mungesë vullneti për ta plotësuar këtë gjë. Kjo shihet shumë qartë te neglizhimi i të gjitha procedurave për ta marrë seriozisht kërkesën që kanë përgatitur dy deputetet.

E theksoj edhe një herë se propozimi i dy deputeteve nuk e zgjidh situatën, ato e thanë edhe vetë, është thjesht një fond fillestar. Në mendimin dhe gjykimin tonë së pari, duhet të anulohet ligji “Për arsimin e lartë” dhe duhet të nisë një diskutim për këtë të fundit.

Së dyti, zbatimi i plotë i ligjit “Për arsimin e lartë” duke marrë parasysh edhe kostot financiare edhe dyfishimin e buxhetit. Fondi që propozojnë zonjat është thjesht një fillim për të bërë disa rregullime që nuk bëhen dot dhe nuk janë marrë masat nga qeveria me të gjitha propozimet që ka bërë ajo edhe me VKM-të e miratuara në fund të vitit.

Nuk dua të diskutoj për ligjin “Për arsimin e lartë”, por dua të theksoj vetëm një fakt: kemi ngritur disa herë shqetësimin e rritjes së tarifave, mesatarisht 33% në disa degë. Rritja e tarifave ka pasur efekt të menjëhershëm menjëherë pas miratimit të ligjit dhe ka sjellë këtë situatë që ka ndodhur sot. Nëse qeveria deri dje thoshte se tarifat i kanë vendosur universitetet, atëherë si po ndërhyr sot për të marrë masa për t’i rregulluar, kur nuk ka pasur asnjë problem?!

Prandaj po them edhe një herë, ta njohim problemin të gjithë, të biem dakord të gjithë për problematikën dhe ta shoqërojmë zgjidhjen e saj edhe me buxhetin përkatës.

Propozimi që kanë bërë të dyja deputetet mund të akomodohet shumë mirë, ne si deputetë të Komisionit për Ekonominë mund të japim propozime pa fund se ku mund të ulen zërat e shpenzimeve abuzive dhe korruptive të buxhetit të shtetit për të gjetur një zgjidhje për buxhetin e arsimit. Le ta kemi si një hap të parë.

Shpresoja shumë që sot ministrja e Financave të na jepte një përgjigje, por ajo u largua, nuk është njohur me materialin. Shpresoj që të paktën në ditët në vijim ta kemi këtë gjë në pikën e parë të rendit të ditës.

Kemi shpenzuar kohë, një muaj e gjysmë pa përgjigje nga qeveria. Mendoj se ju si kryetar i Komisionit, duhet që menjëherë të merrni masa, që t’i shkojë qeverisë dhe të fillojë të analizohet.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Për dijeninë tuaj qeveria është përgjigjur me urgjencë dhe me rigorozitet për sa u përket të gjitha kërkesave të studentëve, është një paketë e tërë vendimesh në funksion të kërkesave legjitime të studentëve: ulja e tarifave.

Për sqarim, nga ana teknike nuk është ndërhyrë në tarifa, por referohet në rritjen e subvencionit që qeveria u jep universiteteve. Pra, teknikisht duhet ta dallojmë shumë mirë këtë gjë, nuk është ndërhyrë në tarifë, por është rritur subvencioni i buxhetit të shtetit ndaj universiteteve.

Paketa është e plotë, i referohet uljes së tarifave, si dhe të gjithë kërkesave të tjera ku mund të përmendim përfaqësimin, apo të gjithë kujdesin. Brenda paktit për universitetin ka edhe një paketë sociale, që u referohet familjeve me ndihmë ekonomike apo një grupi, i cili është konsideruar në bazë të logjikës së VKM-ve në nevojë, që marrin edhe bursë, edhe përjashtohen 100% nga tarifat.

Unë para se t’ia jap fjalën sërish relatores, dua të theksoj se në të drejtën tuaj, menjëherë në bazë të procedurës parlamentare projektligji, propozimet do t’i shkojnë Këshillit të Ministrave, sepse edhe neni 82, në mos gaboj, i Kushtetutës, referohet specifikisht: “Asnjë projektligj joqeveritar, që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit”. Kështu që, menjëherë pas kësaj mbledhjeje ne do t’ia dërgojmë propozimin tuaj Këshillit të Ministrave dhe sapo të vijë përgjigja nga Këshilli i Ministrave do të mbledhemi sërish për të diskutuar.

Fjalën e ka zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – Shumë faleminderit!

Dua të falenderoj dy koleget për shprehjen e një ndjeshmërie shumë të madhe publike për mbështetjen buxhetore të arsimit. Këtu kam shifrat e buxhetit të arsimit që nga viti 2013 dhe vë re që oshilacionet që ka pasur buxheti për arsimin që nga viti 2013 e deri sot janë akoma shumë larg objektivit që është vënë nga maxhoranca në vitin 2013, që arsimi të marrë 5% të prodhimit të përgjithshëm bruto.

Unë mendoj se çështja e arsimit dhe e financimit të tij duhet të jetë ndjeshmëria më e madhe kombëtare. Fatkeqësisht, shikoj që këtu marrim pozicione partiake. Disa mbrojnë buxhetin kështu siç është apo merren me procedura.... Ta lëmë mënjatë pozicionimin partiak dhe të kuptojmë që

propozimi i kolegeve është një kampanë shumë e fortë për domosdoshmërinë për ta marrë çështjen e trajtimit të arsimit si një sfidë të madhe kombëtare. Mendoj se është sfida më e madhe kombëtare që kemi sot. Pasojat që vijnë nga problemet që ka sistemi arsimor janë shumë mirë të reflektuara në dëshirën e të gjithë të rinjve për të lënë vendin. Nuk është vetëm problemi i tyre, nuk është çështje e perceptimit të tyre që duan të largohen. Shikoni gjendjen e administratës publike. E patë raportin e Bashkimit Europian çfarë thoshte. Është një shkatërrim total. Pse vjen kjo? Nga cilësia e arsimit. Aty e gjej zgjidhjen.

Probleme të tjera vijnë nga biznesi. Kërkojnë njerëz të kualifikuar, thonë që ka vende pune, por nuk kemi njerëz të kualifikuar. I kujt është problemi? Është i sistemit arsimor. Edhe këtu kemi dështim shumë të madh. Mendoj se kjo nuk është çështje partiake apo maxhorance. Në gjykimin tim duhet të lëmë pozicionimet dhe llogoret politike dhe ta trajtojmë çështjen e arsimit si një sfidë të madhe kombëtare. Çështja e arsimit ka nevojë për një strategji të madhe kombëtare me qëllim që t'i kthejmë besimin rinisë se ky vend bëhet, se ky vend ka shumë nevojë për ta dhe patjetër që këto gjëra mund të zgjidhen dhe bëhen nga përfaqësuesit politikë që ata kanë zgjedhur.

Prandaj, ju ftoj të reflektoni, të lini për një moment ngjyrimet partiake që keni dhe të kuptoni që kjo kampanë, që i bien këto kolege, është kambana e një tragjedie kombëtare. Largimi i rinisë dhe tkurrja e popullsisë janë potencial për një tragjedi të madhe kombëtare. Prandaj, shikojeni në këtë këndvështrim. Gjithçka fillon tek arsimi. Nëse nuk do t'i përgjigjemi siç duhet, duke lënë edhe gjërat e tjera, kërkesave të studentëve ...

Patjetër që ka nevojë për ristrukturim të strukturës së arsimit të lartë. Nuk flasim akoma për këtë. Pse nuk flasim për arsimin profesional, që ka impakt të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike, në profesione, në zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, por flasim për arsimin në përgjithësi? Edhe këtu ka defekte të mëdha për mënyrën si bëhet arsimi. Të rinjtë tanë kanë tendencën të shkojnë tek arsimi i lartë, por jo ai profesional. Një problem tjetër i madh kombëtar ky. Ta konsiderojmë çështjen e mbështetjes buxhetore të arsimit si sfidën më të madhe kombëtare që ka sot Shqipëria. Në qoftë se nuk e bëjmë kështu, do të kemi përgjegjësi në vitet e ardhshme për këtë tkurrje që po i ndodh popullsisë dhe për këtë emigracion të jashtëzakonshëm që po bën rinia sot. Kolege, ju vlerësoj shumë për propozimin që keni bërë!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Haxhinasto!

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Është shumë e rëndësishme të themi se për atë që po ndodh sot reagimi i qeverive të mëparshme ka qenë edhe më i pakët. Një pjesë e jona që kemi punuar në mësimdhënie në akademi i njohim shumë mirë shqetësimet dhe problematikat. I rëndësishëm është fakti i kuptimit të situatës, problematikave që ka dhe adresimit të tyre pikërisht për të treguar një përgjegjshmëri të madhe politike ndaj të gjithë të rinjve. Kjo për faktin që çfarë ne investojmë sot në arsim, i shërben ndërtimit të shoqërisë të së ardhmes.

Pikërisht për këtë, mjafton të shikojmë paketën e masave dhe vendimeve të qeverisë në përgjigje të kërkesave të studentëve, ku jo vetëm adresohen 8 kërkesat që ata kanë, por shkohet në thelb të problemit për të zgjidhur atë problem që të gjithë kemi hasur në auditorë apo diskutime me pedagogë dhe studentë.

Për mua është shumë i rëndësishëm fakti jo kush merr flamurin për të zgjidhur, por kush janë ata që mbledhen bashkë për të adresuar një problematikë kaq të madhe. Këtë e kam edhe për kolegët e opozitës. Mjaft bëmë politikë aty ku duhet të jemi bashkë dhe të themi: po, paketa e qeverisë për t'ju përgjigjur kërkesave të studentëve i adreson problematikat dhe ndoshta duhet të shikojmë më tej, të vijmë alternativa dhe propozime të tjera. Sot ne po flasim për ndryshime në buxhet, ku duhet të shikohet se ku do të ulen dhe ngrihen shpenzimet. Ndërkohë, ndryshimet që reflektohen në buxhet paketa i ka tashmë. 1, 96 miliardë. A mjaftojnë investimet? Jo. A duhet bërë më shumë? Po. Prandaj është pjesa e “Paktit për Universitetin”.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti kryetar!

Për propozimin e dy kolegeve deputete foli zonja Tabaku. Ne mbështesim çdo propozim që synon të zgjidhë qoftë edhe pjesërisht të gjitha problematikat që kanë ngritur studentët e universitetit të Tiranës dhe rretheve. Iniciativa e ndërmarrë nga dy koleget është e lavdërueshme. Pavarësisht problemit shumë të mprehtë, ne përballemi me një zvarritje nga ana e maxhorancës. Propozimi mund të ishte çuar në qeveri, të ishte marrë mendimi dhe të shikonim për rrugët e zgjidhjeve.

Nisur nga fjala e relatores dhe kryetarit të komisionit, shikoj edhe euforinë qeveritare sikur çështjet janë zgjidhur dhe nuk ka probleme. Nëse janë zgjidhur, pse e vazhdojnë grevën studentët? Këtu janë dy palë. Është një palë shumë e rëndësishme, ajo që i ka ngritur dhe ka 50 ditë që po rri

në protestë. Nëse ne i paskemi zgjidhur, pse protestojnë studentët? Si u zgjidhën problemet? Me shkop magjik. Ku i gjetët paratë? Në buxhet nuk ka para për kërkesat e studentëve. Ajo që ju thoni, që i hoqët nga kjo rrugë për t'ia dhënë arsimit, është gënjeshtër, sepse në buxhet nuk janë parashikuar para për ndërtimin e asaj rruge. Për rrjedhojë, e gjithë paketa që ju keni ekspozuar është një gënjeshtër. Kryeministri gënjen. Do që të kalojë problemin e radhës. Thotë që me paratë e rrugës Thumanë-Rrogozhinë do të financoj paketën tuaj. Ky është një problem jashtëzakonisht serioz.

Jam dakord me zotin Haxhinasto kur thotë që është një problem kombëtar për sot e shumë vite. Pjesa dërmuese e problemeve me të cilat ndeshemi kanë të bëjnë me arsimin. Është tragjike të shikosh që 70-80% e të rinjve shqiptarë duan të ikin nga vendi. Në themel të kësaj është arsimi, kështu që duhet zgjidhur.

Në datën 15 janar ne dhamë disa propozime, që janë në linjën e dyfishimit të buxhetit për sektorin e arsimit, nga 74 milionë dollarë të shkojë në 150 milionë dollarë, trajtimit të studentëve sipas nivelit të të ardhurave, si dhe krijimin e një fondi për studentët që vijnë nga familje ekstremisht të varfra, por edhe këto nuk mjaftojnë.

Edhe zonjat që kanë bërë propozimin e dinë shumë mirë që propozimi i tyre nuk i zgjidh të gjitha problemet që ka arsimi, aq më tepër që probleme nuk ka vetëm arsimi universitar, por edhe ai i shkollëve të tjera. Ne duhet të jemi seriozë në trajtimin e këtij problemi. E fillojmë që nga ligji për arsimin e lartë. Jo më kot e kërkojnë edhe studentët edhe pedagogët. Duhet ta anulojmë këtë ligj dhe të punojmë bashkarisht pa qëndrime partiake për një ligj të ri dhe për një platformë të re të zhvillimit të arsimit në Shqipëri, jo sot për sot apo sot për nesër sipas interesit të këtij apo atij, atij oligarku apo atij grupi, por afatgjatë.

Kështu që, duhet zgjidhje afatgjate dhe serioze. Nëse keni kuptuar ndonjë gjë nga protesta e studentëve dhe pedagogëve, të cilët po u bashkohen dhe që do ta ndjeni në datën 1, është të anulojmë ligjin e arsimit të lartë dhe të fillojmë konsultimet me të gjitha grupet e interesit për një zgjidhje afatgjate. Të ndryshojmë buxhetin e shtetit që të rriten fondet për arsimin, edhe për vitin 2019 të dyfishohen, sepse para ka. Mjafton të anulojmë koncesionet me nga 20 milionë euro për kilometër. Në kuptimin afatshkurtër, por edhe afatgjatë të vëmë disa piketa që i shërbejnë arsimit dhe gjithë shoqërisë sonë.

Përfitoj nga rasti të ngre dy shqetësime të mëdha që kanë të bëjnë me grevën e studentëve. Është e patolerueshme futja e policisë në universitete. Pavarësisht se këtu jemi në Komisionin e

Ekonomisë, e dimë se me ligj nuk lejohet që policia të hyjë në universitete. Vetëm me kërkesë të titullarit të institucionit lejohet. Ajo që keni bërë ju, që me kërkesë të administratorit keni futur policët në universitete, është thellësisht e papranueshme. Vetëm Millosheviçi ka futur policinë në vitin 1981 në Universitetin e Prishtinës.

Është e turpshme që Kryeministri përzë studentët nga takimi. Kush është Kryeministri që përzë studentët nga diskutimet që ai organizon? Edhe kërkon të bëjë diskutime, edhe përzë studentët!? As Adil Çarçani nuk i ka përzënë studentët në vitin 1990 kur i thirri për të diskutuar. Kjo është demokracia që po ju ofrojmë pas 28 vjetëve? Këto janë zgjidhet që ofron maxhoranca, e cila thotë që kemi bërë këtë e këtë, dukur futur policinë, duke mos pasur lekë në buxhet, duke përzënë studentët? Nuk janë zgjidhje këto.

Prandaj, fillohuni dhe shikoni problemin me qetësi dhe maturi, sepse jemi në një gjendje shumë kritike.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Spaho!

Përpara se ta mbyllim këtë diskutim unë dua që të komunikojmë nga ky komision me qytetarët. Paketa që ka aprovuar qeveria është e plotë dhe shkon gati në 2 miliardë lekë. Dua t'u kujtoj studentëve dhe qytetarëve një të vërtetë të madhe, fondi i arsimit të lartë në vitin 2012 ka qenë vetëm 3,8 miliardë lekë apo 38 milionë dollarë, kurse sot është 74 milionë dollarë. Tarifat që paguheshin nga studentët në vitet 2012-2013 kanë qenë 3,8 miliardë lekë, pra 38 milionë dollarë. Sot tarifat janë më pak. Kjo do të thotë se studentët sot paguajnë më pak se atëherë. Megjithatë, qeveria vendosi të ulë 50% tarifën në mesatare, duke rritur subvencionin dhe më pas të bëjë paketën sociale, e cila ka të bëjë, qoftë me studentë që vijnë nga familje në nevojë, qoftë me komunitete që janë konstatuar dhe konsideruar brenda vendimit të Këshillit të Ministrave si qytetarë, studentë, që përfitojnë bursë, e cila ka qenë 89 mijë lekë dhe tani është 100 mijë lekë të vjetër.

Gjithsesi, ajo që ju i referoheni, futjes së policisë, nuk është e vërtetë.

Unë e kuptoj shumë mirë se çfarë ka ndodhur. Ju ka trembur qasja e Kryeministrit, e qeverisë dhe e maxhorancës me studentët. Ju e patë që studentët po kuptojnë se Kryeministri, qeveria dhe maxhoranca janë të vetmit aleatë, ndërsa pjesa tjetër është politika që bëni ju, që vini këtu në mënyrë (nuk dua të them fjalë që nuk qëndrojnë ose që tingëllojnë keq)... Vini këtu dhe kërkon uljen e tarifës. Ej, tarifa është ulur! Ka filluar që nga 1 janari.

A e kuptoni që ka 30 vjet, që kur kemi qenë unë dhe Mondit studentë, se Mondit është pak më i ri se unë, që nuk është prekur Qyteti Studenti nga investimet dhe është hera e parë që po preket?!

Po vini të kërkonit një gjë që është bërë?! Vini këtu dhe thoni se do të ulim tarifat. Ej, tarifat janë ulur! Mos thoni në 2018-2019-n se “u fut policia”. Aman, se jemi joseriozë me të vërtetën! Gjithsesi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zonja Tabaku!

Ka të vërteta komplementare. Ajo ka mbaruar, zoti Spaho. Herës tjetër... Ju do të vini vazhdimisht këtu.

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit!

Ne po ia dërgojmë propozimet Këshillit të Ministrave. Do të presim dhe do të bëjmë një diskutim të ri. Faleminderit!

E konsideroj të mbyllur.

Kejdi Mehmetaj – Zoti kryetar, kemi të drejtën për t’u përgjigjur. Ç’është kjo?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk ka kuptim! Kaq frikë keni të përballeni me gjithë këto mashtrime që bëni?!

Zoti kryetar, është përgjegjësia juaj kryesor si ish-ministër...

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti